

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	
EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Projektligj “ Për kontrollet zyrtare dhe veprimtari të tjera zyrtare të kryera për të garantuar zbatimin e legjislacionit mbi ushqimin dhe ushqimin për kafshë, rregullimeve mbi shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve si dhe mbi shëndetin e bimëve dhe produkteve për mbrojtjen e bimëve në Republikën e Shqipërisë”
MINISTRIA UDHËHEQËSE	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
FAZA E POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Finale
BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	I brendshëm
DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së	Përafrim i pjesshëm me Rregulloren Evropiane (BE) 2017/625 “Mbi kontrollet zyrtare dhe aktivitetet e tjera zyrtare të kryera për të siguruar zbatimin e ligjit për ushqimin dhe ushqimin për kafshët, rregullat për shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve, shëndetin e bimëve dhe produktet për mbrojtjen e bimëve”
PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA	- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 460, datë 29.6.2022 “Strategjia për bujqësinë, zhvillimin rural dhe peshkimin 2021-2027”; - Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 16, datë 11.1.2024 ”Plani Kombëtar për Integrimin Evropian 2024” - Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 366, datë 16.6.2023 ”Strategjia Kombëtare për Sigurinë Ushqimore 2023 – 2027”. - Programi Qeverisës 2021-2025; - Agjenda e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor.
DATA E KONSULTIMIT PUBLIK	19.08.2025 - 16.09.2025
DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	23/12/3025
A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT? NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT	Po, 08/09/2025
NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	2025 - MBZHR- Nr. 5

**TE DHËNA KONTAKTI
(EMRI, E-MAIL, NUMRI I
TELEFONIT TËPERSONIT
TË KONTAKTIT)**

Adra Gjongecaj
e-mail-i: Adra.gjongecaj@bujqesia.gov.al
numri i telefonit: 0692325402
Eneida Sokoli
e-mail-i: Eneida.Sokoli@bujqesia.gov.al
numri i telefonit: 0695612584
e-mail-i: Matilda.Xhepa@bujqesia.gov.al
numri i telefonit: 0688384074

**PJESA 1: PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE
(Maksimumi 2 faqe)**

PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT

Cili është problemi në shqyrtim dhe cilat janë shkaqet e tij? Pse është e nevojshme ndërhyrja qeverisë?

Problematikat e evidentuara kanë përgjithësisht natyrë rregullatore dhe paraqiten si më poshtë:

- Mungesa e një mjedisi rregullator të posaçëm i cili do t'i shërbejë përmirësimit të mbrojtjes së shëndetit të konsumatorëve, shëndetit të kafshëve dhe shëndetit të bimëve duke plotësuar mungesën e kuadrit ligjor të posaçëm dhe unifikues për kontrollet zyrtare.
- Mungesë e trajtimit të problematikës bazuar në risk në disa fusha specifike.
- Akses i kufizuar dhe aftësi të dobëta konkurruese të Shqipërisë në tregjet ndërkombëtare të ushqimit.
- Kapacitete jo të mjaftueshme institucionale dhe administrative në funksion të harmonizimit të acquis communautaire të BE-së në fushën e sigurisë ushqimore, shëndetit të kafshëve dhe të bimëve.

1. Mungesa e kuadrit ligjor të posaçëm dhe unifikues për kontrollet zyrtare

- Kuadri ligjor në fuqi nuk është në përputhje me parimet dhe kërkesat e përcaktuara në Rregulloren 2017/625.
- Mospërputhje dhe boshllëqe ligjore pasi sektorëve u mungojnë dispozita përkatëse ligjore që sigurojnë llogaridhënien, qëndrueshmërinë dhe efektivitet gjatë aktivitetit të tyre.
- Autoritetet e kontrollit veprojnë në bazë të qasjeve të ndryshme ligjore rrjedhimisht dhe nën kushte të ndryshme kjo në varësi të rregullave specifike për zinxhirit agroushqimor në ndërkohë duke mos justifikuar ndryshimin e bazës ligjore mbi të cilën ata veprojnë.

Duke zbatuar legjislacionin e njëjtë me atë të BE-së për zinxhirion agro-ushqimor mundësohet monitorimi i kërkesave përkatëse dhe sigurimi i zbatimit të tyre në mënyrë efektive në të gjithë hapësirën e BE-së, në të njëjtën kohë duke verifikuar aktivitetet dhe që mallrat e operatorëve të vendosura në tregun e BE-së (qoftë të prodhuara në BE ose të importuara nga vendet e treta) përputhen me standardet dhe kërkesat përkatëse të zinxhirit agro-ushqimor.

2. Mungesë e trajtimit të problematikës bazuar në risk në disa fusha specifike

- Mungesa e ushtrimit të kontroleve zyrtare me bazë risku gjatë importit për mallra të caktuara siç janë mbetjet e produkteve veterinare.
- Mungesë e mekanizmit të duhur për të vlerësuar riskun që paraqitet në kufi nga një mall i caktuar, OB apo shteti nga i cili importohet.
- Ushtrimi i kontrollit i pabazuar në risk sjell anazhim të panevojshëm duke keqpërdorur shërbimet publike dhe duke sjellë ngarkesë të panevojshme për operatorët (koha, stafi, paisjet dhe objektet e mobiluara për të lëjuar kontrollet.

3. Akses i kufizuar dhe aftësi të dobëta konkurruese të Shqipërisë në tregjet ndërkombëtare të ushqimit

Shqipëria kërkohet të miratojë dhe të zbatojë politikat e sigurisë agroushqimore, të cilat nga ana e tyre sigurojnë që çdo palë e interesuar të kuptojë dhe të luajë siç duhet rolin e tyre. Zbatimi efektiv këtyre politikave kërkon përkufizimin e qartë të roleve dhe përgjegjësiave për çdo palë të përfshirë dhe angazhimin e tyre në vijimësi për zbatimin e objektivave të politikës brenda kompetencave të tyre përkatëse përmes planeve për zbatimin të politikave. Kjo politikë përcakton parimet kryesore të njohura ndërkombëtarisht, sipas të cilave sistemet e prodhimit agroushqimor në Shqipëri duhet të rregullohen për të garantuar mbrojtjen e shëndetit të konsumatorit, shëndetin e kafshëve dhe bimëve, duke lehtësuar inovacionin dhe tregtinë duke siguruar kështu akses të pakufizuar në tregjet ndërkombëtare dhe tregun e BE-së me vëmendje të veçantë.

5. Dobësitë e kuadrit ligjor shqiptar në fuqi

Aktualisht, në sistemin rregullator shqiptar ka disa mangësi specifike, në veçanti baza e kufizuar e provave për fusha kyç, si: i. incidenca në nivel vendi e rreziqeve dhe sëmundjeve të shkaktuara nga ushqimi, duke përfshirë rreziqet dhe sëmundjet për shëndetin e kafshëve; ii. kostoja ekonomike e ushqimeve të pasigurta; dhe iii. efikasiteti i ndërhyrjeve në sigurinë ushqimore. Këto mangësi lidhen me numrin e skenarëve ekzistues, duke përfshirë faktorë institucionalë, si copëzimi i zinxhirëve të vlerave ushqimore dhe mandatet institucionale publike, si dhe mungesa e përfaqësimit të efektshëm të konsumatorëve dhe operatorëve të bizneseve ushqimore. Për të forcuar sistemin rregullator duhen adresuar një sërë sfidash specifike, që përfshijnë disponueshmërinë e të dhënave për informim të monitorimit dhe mbikëqyrjes me bazë risku, pikat e dobëta që ekzistojnë në sistemet e sigurisë ushqimore dhe të shëndetit të kafshëve, lidhur me evidencat shkencore, infrastrukturën e nevojshme, burimet e trajnuara njerëzore, kulturën e sigurisë ushqimore dhe rregulloret e zbatueshme¹.

6. Kapacitete jo të mjaftueshme institucionale dhe administrative në funksion të harmonizimit të *acquis communautaire* të BE-së

Kjo politikë propozon rregulla dhe kritere në funksion të ruajtjes së shëndetit të njerëzve, kafshëve dhe mjedisit në përputhje me qasjen “One Health”, e cila njeh ndërlidhjet midis këtyre fushave kyçe të bujqësisë. Kjo politikë mbulon të gjitha fazat përgjatë zinxhirit nga ferma në tavolinë, duke përfshirë kontrollin e sigurisë së ushqimit dhe ushqimit të kafshëve, shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve dhe shëndetin e bimëve. Për realizimin e vizionit, zbatimin e rregullave dhe parashikimeve që sjell Rregullorja 2017/625, e cila

¹ Vendim Nr. 366, datë 16.6.2023 “Për miratimin e strategjisë kombëtare të sigurisë ushqimore 2023–2027”, fq.3

përafrohet në kuadrin ligjor shqiptar, nevojitet jo vetëm puna për sjelljen e kësaj politike objektivisht si pjesë e piramidës ligjore në shtetin tonë por edhe egzistencën e njësive përkatëse të cilat do t'ia zbatojnë atë në praktikë. Detyrat janë të mirëpërcaktuara por për zbatimin e tyre nevojiten ekspertë të fushave të caktuara për të cilët trajnimi duhet të jetë i vazhdueshëm në përpjekje për arritjen e standarteve europiane në afat dhe me rezultate të larta.

Grupet e ndikuar janë:

- o Qeveria;
- o Fermerët, kultivuesit e bimëve dhe kafshëve;
- o Industria përpunuese/ushqimore, me theks të veçantë në prodhimin e ushqimit me origjinë shtazore;
- o Organizatat e prodhuesve dhe shoqatat e prodhuesve bujqësorë;
- o Komuniteti dhe shoqëria.

Me përafrimin e legjislacionit të Shqipërisë me *acquis communautaire* në fushën e sigurisë ushqimore synohet që Shqipëria të zbatojë të njëjtat standarte me BE-në në përputhje me standartet dhe kërkesat përkatëse të zinxhirit ushqimor duke verifikuar para së gjithave operatorët e bizneseve dhe mallrat që do të qarkullojnë në tregun e brendshëm dhe atë të BE-së (qoftë të prodhuara ose të importuara nga BE-ja apo vendet e tjera të treta).

OBJEKTIVAT

1. Deri në fund të vitit 2028, të reduktohen me 20% rastet e shkeljeve të raportuara për sigurinë ushqimore, përmes standardeve më të forta dhe inspektimeve të rregullta. Forcimi i mjedisit rregullator në funksion të përmirësimit të mbrojtjes së shëndetit të konsumatorëve, shëndetit të kafshëve dhe shëndetit të bimëve brenda vitit 2028 si dhe sigurimi i të paktën 2 inspektimeve në vit për cdo OBU.
2. Ruajtja dhe trajtimi i kujdeshëm i interesave të operatorëve të biznesit në fushën e sigurisë ushqimore monitorimi për këtë qëllim brenda vitit 2028.
3. Krijimi i aksesit të pakufizuar dhe rritjen e aftësive konkurruese për Shqipërinë në tregjet ndërkombëtare të ushqimit deri në vitin 2028, të dyfishohen marrëveshjet e njohjes reciproke dhe certifikatat fitosanitare, duke rritur me 30% volumin e eksporteve ushqimore. Promovimi i prodhimit dhe i cilësisë së qëndrueshme të ushqimit nëpërmjet zhvillimit të një sektori konkurrues dhe inovativ agroushqimor.
4. Forcimi i kapacitetet institucionale dhe administrative drejt harmonizimit të *Acquis Communautaire* të BE-së në fushën e sigurisë ushqimore, shëndetit të kafshëve dhe të bimëve deri në vitin 2028, do të sigurohet njohje reciproke më e madhe për marrëveshjet dhe certifikatat fitosanitare, duke rritur me 15% volumin e eksporteve ushqimore si dhe trajnimi i stafit administrativ brenda vitit 2028.
5. Përgatitja e kuadrit ligjor përkatës, që rregullon kontrollet zyrtare, në lidhje me sigurinë ushqimore, shëndetin e kafshëve dhe të bimëve në të njëjtën linjë me parashtrimet e kuadrit ligjor të BE-së (*EU acquis*), në kuadrin e një politike kombëtare të konsoliduar.

OPSIONET E POLITIKAVE

Cilat janë opsionet kryesore të politikave, duke përfshirë mënyrat ndaj rregullimit? Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/përfitimeve kryesore dhe të dizavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme. Duhet të përcaktoni detajet në lidhje me opsionin e preferuar.

Opsioni 0 – Ruajtja e status quo-së; Qëndrimi në gjendjen aktuale, duke zbatuar ligjet aktuale në fuqi për kontrollet zyrtare, nënkupton mos dhënien e një zgjidhjeje problematikave të evidentuara, mos adresimin e tyre me kahje nga BE si dhe mos plotësimin e detyrimeve për përafrimin ligjor me *acquis* e BE-së.

Opsioni 1 - (rregullator): Miratimi i një ligji të ri i cili unifikon kuadrin ligjor i cili përcakton rregullat për kontrollet zyrtare në fushën e sigurisë ushqimore, ushqimin dhe ushqimin për kafshë dhe mbrojtjen e bimëve duke dhënë jep zgjedhjen e duhur problematikave të evidentuara dhe duke ecur në drejtim të forcimit të tregut të brendshëm dhe atij europian si rezultat i përmbushjes së standarteve europian në këto fusha. Ky është opsioni i zgjedhur nga ne si më i përshtatshëm, i cili trajton dhe zgjidh një sërë çështjesh problematike në kohë, dhe që jep rezultatet e duhura në raport objektivat që Qeveria synon të përmbushë. Harmonizimi me *acquisin* e BE-së bëhet me qëllim të krijimit të një qasje të integruar dhe uniforme ndaj kontrolleve zyrtare përgjatë zinxhirit agro-ushqimor. Nisma ligjore që propozojmë ofron një kuadër të përgjithshëm, të unifikuar për kontrollet zyrtare në sektorët e ushqimit dhe ushqimit për kafshë, duke përcaktuar dispozita të qarta për rregullimin, organizimin dhe financimin e kontrolleve zyrtare.

Opsioni 2 - (rregullator): Rishikimi i ndryshimeve ligjore në ligjislacionin aktual nuk adreson problematikat e evidentuara duke mos patur një kuadër ligjor solid dhe të unifikuar e duke mos marrë si pasojë rezultatet e pritshme në aspektin e përafrimit të legjislacionit me *acquis* por edhe duke mos dhënë zgjidhje problematikave si pasojë e fragmentizimit ligjor, identifikimin jo të plotë dhe mbivendosjen e kompetencave mes organeve zbatuese legjislative.

Opsioni 3 – (jorregullator): Ky opsion do të ishte forcimi i zbatimit të ligjit egzistues në fuqi nga strukturat kompetente. Trajnimi i stafit, forcimi i kërkesës së llogarisë, analizimi i terrenit më i shpeshtë etj. Qeveria mund të fokusohet në forcimin e zbatimit të rregulloreve dhe legjislacionit ekzistues, trajnimeve dhe mbikëqyrjes më të fortë të institucioneve dhe operatorëve të biznesit në këta sektorë. Ky opsion nuk ofron zgjidhjen e duhur për problematikat e evidentuara dhe as përmbushjen e qëllimeve që ka vënë Qeveria Shqiptare për arritjen e kushteve të anëtarësimit në BE.

ANALIZA E NDIKIMEVE

Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar? Kjo duhet të përfshijë ndikimet me vlerë monetare të përcaktuar dhe ndikimet pa vlerë monetare të përcaktuar mbi buxhetin dhe bizneset.

Opsioni i preferuar është **Opsioni 1 (rregullator):** Miratimi i një ligji të ri i cili unifikon kuadrin ligjor i cili përcakton rregullat për kontrollet zyrtare në fushën e sigurisë ushqimore, ushqimin dhe ushqimin për kafshë dhe mbrojtjen e bimëve duke dhënë jep zgjedhjen e duhur problematikave të evidentuara dhe duke ecur në drejtim të forcimit të tregut të brendshëm dhe atij europian si rezultat i përmbushjes së standarteve europian në këto fusha. Ky është opsioni i zgjedhur nga ne si më i përshtatshëm, i cili trajton dhe zgjidh një sërë çështjesh problematike në kohë, dhe që jep rezultatet e duhura në raport objektivat që Qeveria synon të përmbushë. Rritja e efikasitetit të përdorimit të burimeve të kontrollit në bazë risku në rrezik dhe mobilizimi i burimeve financiare të destinuara për këtë qëllim, zvogëlon presionin mbi buxhetin e shtetit, bën të mundur vijëmsinë e ecurisë drejt

realizimit të objektivit kryesor që është siguimi i efikasitetit të kontrolleve dhe rritja e sigurisë së zinxhirit agro-ushqimor. Shtetet zbatuese të kësaj politike mund të përjashtojnë pjesërisht ose plotësisht nga tarifat mikro-ndërmarrjet, në përputhje me legjislacionin në fuqi për asistencën shtetërore në këtë fushë.

Është e nevojshme të theksojnë se tarifat e detyrueshme siç janë të parashikuara aktualisht nuk lejojnë AK-së të rikuperojë të gjitha kostot e tyre duke mundur kështu të sigurojë një fluks të qëndrueshëm burimesh për të financuar zhvillimet e kontrolleve zyrtare në lartësinë e shpeshtësinë e nevojshme.

Megjithatë, përfitimet në aspektin e rritjes së efikasitetit dhe konkurrueshmërisë do të ishin vetëm të pjesshme sepse shëndeti i bimëve në legjislacionin aktual nuk përfshihen. Në fakt, organizimi i mirë dhe efikas mund të arrihet vetëm duke siguruar që përparësia e vlerësimit të riskut të kryhet nga AK-të në të gjithë sektorët e zinxhirit agro-ushqimor, duke përfshirë edhe ato më sipër. Kjo parandalohet duke shmangur fragmentimin aktual i legjislacionit të kontrolleve zyrtare.

Sa i përket aspektit financiar të kontrolleve zyrtare, kërkesa që kostot e kontrolleve kur përdoren tarifa të detyrueshme të mbulohen nga OB-të do të krijojnë një bazë financiare të qëndrueshme të mbledhur përmes tarifave të tilla, duke zvogëluar kështu presionin mbi buxhetet e shtetit. Në shumicën e shteteve anëtare të BE-së, kostot e kontrollit mbulohen vetëm pjesërisht përmes tarifave të OB-ve kjo nismë politike parasheh mundësinë në disa raste që një pjesë shtesë të kostove të kontrolleve të transferohen dhe të shpërndahen midis operatorëve të zinxhirit agro-ushqimor. Rritja e nivelit të tarifave të detyrueshme pritet të mos përfaqësojë një barrë shtesë të konsiderueshme për operatorët e biznesit, madje edhe në ato sektorë ku kostoja e kontrolleve ndikon më shumë në kostot e përgjithshme të prodhimit të operatorëve, sic është inspektimi i mishit.

Grupet e prekura:

Projektligji ndikon në mënyra të ndryshme mbi këto grupe:

1. Qeveria:

- Përbush qëllimet e saj për standarte europiane dhe përafrimin e të BE-së me legjislacionin e brendshëm.
- Përforon kuadrin rregullator mbi kontrollet lidhur me ushqimin, ushqimin për kafshë, shëndetin e bimëve, sigurinë ushqimore, produktet mjekësore veterinarë duke eliminuar fragmentizimin në të njëjtën kohë.
- Plotëson standardet e BE-së për sektorin bujqësor mbi kontrollet zyrtare, duke përmirësuar imazhin ndërkombëtar dhe plotësuar një kusht të rëndësishëm për anëtarësimin në BE.
- Modernizimi i sektorit të bujqësisë duke ofruar një bazë solide, të gjërë të të dhënave mbi sektorët e bujqësisë.

2. Fermerët:

- Duhet të përbushin masa të reja biosigurie dhe standarde fermash.
- Përfitime nga rritja e të ardhurave, standardeve të jetesës dhe akses në subvencione.

3. Komuniteti dhe shoqëria civile:

- Përfitime sociale përmes modernizimit të sektorit bujqësor dhe përmirësimit të cilësisë së produkteve.
- Hapja e vendeve të punës dhe përmirësimi i jetesës në zonat rurale

4. Punëmarrësit:

- Mundësi të reja punësimi dhe zhvillimi profesional.
- Lehtësi në mbarëvajtjen e tyre në zhvillimin e biznesit me rezultate në zgjerimin e aktivitetit ekonomik e për rrjedhojë rritjen e nevojës për punësime të reja.
- Përmirësim i kushteve të punës dhe hapje e vendeve të punës në zonat rurale.

5. Operatorët e Bizneseve:

- Përballen me kosto fillestare për përmbushjen e rregullave të reja dhe kushteve ligjore.
- Përfitime nga rritja e tregut të brendshëm dhe hapja e tregjeve europiane.
- Rritje e standardeve dhe cilësisë së produkteve, përmirësim i kushteve të punës dhe mundësi bashkëpunimi ndërkombëtar.

6. Prodhuesit e Produkteve me Origjinë Shtazore:

- Përmirësim i cilësisë së produkteve dhe akses në tregjet ndërkombëtare.
- Nevojë për investime në teknologji moderne, por kthimi i investimit është afatgjatë.

7. Industria Përpunuese:

- Investime në makineri dhe teknologji për të përmbushur standardet e reja.
- Rritje të shitjeve, sigurisë ushqimore dhe cilësisë së produkteve për konsumatorët.

Ndikimet Kryesore të Projektligjit:

1. Sociale:

- Nxit rritjen e standardeve të jetesës përmes punësimit dhe zhvillimit rural.
- Përfitime për komunitetet rurale nga zhvillimi ekonomik dhe social.
- Përmbushje e kushteve për anëtarësimin në BE synim arritja e të cilit impakton në mënyrë thelbësore, pozitive shoqërinë shqiptare e cila bëhet pjesë e komunitetit europian me te drejta dhe detyrime të plota si shtet anëtar.

2. Ekonomike:

- Zhvillimet e bizneseve kanë efekte pozitive në rritjen e eksportit dhe tregtisë duke forcuar ekonominë kombëtare.
- Forcim dhe mirëfunksionim i tregut të brendshëm dhe rritje e aftësive konkurruese në tregun europian.
- Krijimi i aksesit të pakufizuar në tregun europian dhe më gjërë pritet të ketë impakt shumë pozitiv në ekonominë e vëndit, rritja e eksportit dhe tregtisë gjithashtu forcon ekonominë kombëtare.
- Përfitime nga investitorë të huaj dhe grantë nga BE;
- Investimet në standarde dhe teknologji krijojnë kosto fillestare, por përkthehen në përfitime afatgjata për të gjitha palët.

3. Mjedisore:

- Zhvillimi i sektorit bujqësisë në zonat rurale pritet të ketë ndikim pozitiv në ruajtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm të aktiviteteve bujqësore,
- Ligji i ri do të ketë një ndikim pozitiv të drejtpërdrejtë në mjedis nëpërmjet kontrollit dhe gjurmueshmërisë më të mirë të bimëve dhe duke reduktuar rrezikun e dëmeve të mëdha mjedisore që vijnë si rrjedhojë e përhapjes së dëmtuesve në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- Më pak produkte për mbrojtjen e bimëve si rezultat i bimëve më të më të shëndetshme duke ulur njëkohësisht nivelin e ndikimit në mjedis të mbetjeve që vijnë nga PMB-të ose ambalazhimi i tyre.
- Modernizimi i sektorit të bujqësisë impakton rritjen e standardeve ekonomike të njësive ekonomike të cilat ndërmarrin veprimtari ekonomike në bujqësi ose mirëmbajnë tokën bujqësore në gjendje të mirë bujqësore dhe mjedisore brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

Kosto dhe Përfitime:

- **Kosto të Sektorit Privat:** paraqiten kosto ekonomike për operatorët e biznesit pasi parashikohen kosto të cilat do të paguheshin nga OB për kontrollet zyrtare. Tarifat zyrtare do të vendosen me Vendim të Këshillit të Ministrave.

- **Përfitime të Sektorit Privat:** Hapja e tregjeve europiane për kafshë, produkte shtazore dhe bimë, krijimi i aksesit të pakufizuar në tregun evropian gjë e cila ka efekt përmirësimit të cilësisë dhe rritjen e të ardhurave nga eksporti.
- **Kosto të Sektorit Publik:** Nuk identifikohen kosto të sektorit publik pasi kompetencat do zbatohen nga strukturat egzistuese.
- **Përfitime të Sektorit Publik:** Nuk identifikohen kosto të reja të konsiderueshme për sektorin publik, pasi strukturat ekzistuese do të mbulojnë kompetencat. Përfitimet përfshijnë rritjen e të ardhurave nga taksat dhe doganat, si dhe përmirësimin e mirëqenies së shoqërisë në plan afatgjatë si dhe ulje e barrës në buxhetin e shtetit si pasjë e shpërndarjes së efekteve financiare të kryerjes së kontrolleve të OB-të.

Qëllim kryesor i këtij projekligji është rregullimi ligjor i kontrolleve zyrtare përgjatë zinxhirit agro-ushqimor përmes një qasjeje të integruar dhe uniforme. Projekligji ofron një kornizë të përgjithshme për kontrollet zyrtare në sektorët e ligjit për ushqimin dhe ushqimin e kafshëve, shëndetit të kafshëve dhe rregullave të mirëqenies së kafshëve, duke përcaktuar rregulla që rregullojnë si organizimin ashtu edhe financimin e këtyre kontrolleve zyrtare.

Opsioni i përzgjedhur nga ana jonë parashikon kosto për sektorin privat por pritet që këto kosto të jenë të kontrolluara të cilat nuk rëndojnë biznesin si dhe parashikimi i prejashtimeve të tjera. Pritshmëritë për ndikime afatgjata janë të larta dhe me rezultate pozitive sociale, ekonomike dhe mjedisore duke justifikuar kështu kostot. Rritja ekonomike dhe përmbushja e standardeve të BE-së pritet të kenë një ndikim pozitiv për zhvillimin e qëndrueshëm të bujqësisë dhe të vendit më gjërë, duke mbështetur kështu edhe objektivat kombëtare për integrim evropian dhe mirëqenie të shtuar për shoqërinë.

ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR

Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opsionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare.

Opsioni i rekomanduar/i preferuar:

Nga analiza me shumë kritere e kryer për të katër opsionet tregoi se **Opsioni 1**, hartimi i projektligjit “Për kontrollet zyrtare” është vlerësuar me më shumë pikë duke e zgjedhur nga ana jonë si opsionin e preferuar. Ky opsioni është zgjedhur si opsioni më i përshtatshëm, më i plotësuar dhe më i zbatueshëm. Problematika e identifikuar është e natyrës rregullatore dhe trajtohet përmes plotësimit të kuadrit ligjor me miratimin e projektligjit “Për kontrollet zyrtare dhe veprimtari të tjera zyrtare të kryera për të garantuar zbatimin e legjislacionit mbi ushqimin dhe ushqimin për kafshë, rregullimeve mbi shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve si dhe mbi shëndetin e bimëve dhe produkteve për mbrojtjen e bimëve në Republikën e Shqipërisë”.

Opsioni 1 - (rregullator): Miratimi i një ligji të ri i cili unifikon kuadrin ligjor i cili përcakton rregullat për kontrollet zyrtare në fushën e sigurisë ushqimore, ushqimin dhe ushqimin për kafshë dhe mbrojtjen e bimëve duke dhënë jep zgjedhjen e duhur problematikave të evidentuara dhe duke ecur në drejtim të forcimit të tregut të brendshëm dhe atij evropian si rezultat i përmbushjes së standardeve evropian në këto fusha. Ky është opsioni i zgjedhur nga ne si më i përshtatshëm, i cili trajton dhe zgjidh një sërë çështjesh problematike në kohë, dhe që jep rezultatet e duhura në raport objektivat që Qeveria synon

të përmbushë. Harmonizimi me *acquisin* e BE-së bëhet për arsye të krijimit të një qasje të integruar dhe uniforme ndaj kontrolleve zyrtare përgjatë zinxhirit agro-ushqimor. Nisma ligjore që propozojmë ofron një kuadër të përgjithshëm, të unifikuar për kontrollet zyrtare në sektorët e ushqimit dhe ushqimit për kafshë, duke përcaktuar dispozita të qarta për rregullimin, organizimin dhe financimin e kontrolleve zyrtare. Gjithashtu, projektligji parashikon sanksione financiare të rënda, me gjopa që variojnë nga 100,000 deri në 2,000,000 lekë, në varësi të natyrës dhe rëndësisë së shkeljes. Këto masa synojnë të sigurojnë respektimin e standardeve më të larta të sigurisë dhe të mbrojnë konsumatorin nga rreziqet e mundshme.

Rritja e efikasitetit të përdorimit të burimeve të kontrollit në bazë risku në rrezik dhe mobilizimi i burimeve financiare të destinuara për këtë qëllim, zvogëlon presionin mbi buxhetin e shtetit, bën të mundur vijëmsinë e ecursë drejt realizimit të objektivit kryesor që është siguimi i efikasitetit të kontrolleve dhe rritja e sigurisë së zinxhirit agro-ushqimor. Shtetet zbatuese të kësaj politike mund të përjashtojnë pjesërisht ose plotësisht nga tarifat mikro-ndërmarrjet, në përputhje me legjislacionin në fuqi për asistencën shtetërore në këtë fushë.

Opsioni 1 mundëson zbatimin e plotë të qasjes kontroll me bazë risku në sektorë ku autoritetet kompetente aktualisht nuk e realizojnë këtë si p.sh. kontrollet zyrtare të kryera në kufijtë e BE-së mbi mallra të caktuara nga vendet e treta dhe kontrollet zyrtare mbi mbetjet e barnave veterinarë. Kjo do të rezultojë në organizim më efikas të programeve të kontrollit. Për më tepër, mundësimi i autoriteteve kombëtare për të përqendruar fokusin e tyre aty ku risku paraqitet më i lartë minimizon barrën e kontrolleve zyrtare mbi ato biznese të cilat përmbushin kushtet ligjore e për rezultat rritje e aftësive të tyre konkurruese në treg.

Megjithatë, përfitimet në aspektin e rritjes së efikasitetit dhe konkurrueshmërisë do të ishin vetëm të pjesshme sepse shëndeti i bimëve në legjislacionin aktual nuk përfshihen. Në fakt, organizimi i mirë dhe efikas mund të arrihet vetëm duke siguruar që përparësia e vlerësimit të riskut të kryhet nga AK-të në të gjithë sektorët e zinxhirit agro-ushqimor, duke përfshirë edhe ato më sipër. Kjo parandalohet duke shmangur fragmentimin aktual i legjislacionit të kontrolleve zyrtare.

Sa i përket aspektit financiar të kontrolleve zyrtare, kërkesa që kostot e kontrolleve kur përdoren tarifa të detyrueshme të mbulohen nga OB-të do të krijontë një bazë financiare të qëndrueshme të mbledhur përmes tarifave të tilla, duke zvogëluar kështu presionin mbi buxhetet e shtetit. Në shumicën e shteteve anëtare të BE-së, kostot e kontrollit mbulohen vetëm pjesërisht përmes tarifave e OB-ve kjo nismë politike parasheh mundësinë në disa raste që një pjesë shtesë të kostove të kontrolleve të transferohen dhe të shpërndahen midis operatorëve të zinxhirit agro-ushqimor. Rritja e nivelit të tarifave të detyrueshme pritet të mos përfaqësojë një barrë shtesë të konsiderueshme për operatorët e biznesit, madje edhe në ato sektorë ku kostoja e kontrolleve ndikon më shumë në kostot e përgjithshme të prodhimit të operatorëve, sic është inspektimi i mishit.

Nisma ligjore që propozojmë identifikon një numër aktivitete të kontrollit (kryesisht mbi mishin, qumështin, prodhimin e peshkimit dhe mbi kontrollet e kryera që kryehen në kufinj) për të cilat autoritetet kompetente do të mbledhin një tarifë nga operatorët (tarifë e detyrueshme) për të rikuperuar kostot e kontrollit. Rregullorja 2017/625 ka lënë të hapur

mundësinë ë zgjedhjes për aktivitete të tjera kontrolli, për të cilat shtete do të vendosin në mënyrë të pavarur nëse do të ngarkojë një tarifë mbi operatorët apo jo.

Megjithatë është e nevojshme të theksojnë se tarifët e detyrueshme siç janë të parashikuara aktualisht nuk lejojnë AK-së të rikuperojë të gjitha kostot e tyre duke mundur kështu të sigurojë një fluks të qëndrueshëm burimesh për të financuar zhvillimet e kontrolleve zyrtare në lartësinë e shpeshtësinë e nevojshme.

Opsioni 1 do të krijonte barazi për të gjithë operatorët e ngarkuar me tarifa të detyrueshme. Dispozitat e reja do të sigurojnë që mekanizmi i financimit të kontrolleve mund të përdoret nga SHM për të shpërblyer bizneset me performancë të mirë dhe me risk të ulët, edhe kur tarifët me normë fikse zbatohen për të gjithë operatorët, pavarësisht nëse ata inspektohen në të vërtetë gjatë periudhës referuese (duke i ngarkuar ata me një tarifë më të ulët se ajo e aplikuar për operatorët që nuk përputhen). Kostot shtesë priten të jenë të përballueshme nga buxhetet publike.

Opsioni 1 parashikohet të rrisë llogaridhënien e aktiviteteve të kontrollit duke krijuar një transparencë të plotë lodhur me kostot dhe tarifët duke përdorur mekanizma ligjorë përmes së cilëve operatorët do të jenë në dijeni të plotë mbi kostot dhe tarifët të cilat priten të paguhet prej tyre.

Gjatë punës për draftimin e Raportit të Vlerësimit të Ndikimit janë marrë në konsideratë edhe dokumentet shoqëruese të Rregulloren Evropiane (BE) 2017/625 “Mbi kontrollet zyrtare dhe aktivitetet e tjera zyrtare të kryera për të siguruar zbatimin e ligjit për ushqimin dhe ushqimin për kafshët, rregullat për shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve, shëndetin e bimëve dhe produktet për mbrojtjen e bimëve” e cila do të përafrohet pjesërisht me miratimin e propozimit të nismës që sjell Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, “Për kontrollet zyrtare dhe veprimtari të tjera zyrtare të kryera për të garantuar zbatimin e legjislacionit mbi ushqimin dhe ushqimin për kafshë, rregullimeve mbi shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve si dhe mbi shëndetin e bimëve dhe produkteve për mbrojtjen e bimëve në Republikën e Shqipërisë”. Në mënyrë të veçantë përmendim këtu Impact Assessment i cili është dokumenti shoqërues i rregullores së sipërcituar dhe i cili është përdorur si referencë gjatë draftimit të këtij dokumenti, duke e sjellë atë në frymën e përshtatshme për mjedisin ligjor shqiptar, në përputhje me rregullat e përafrimit të *acquis communautaire* e duke bërë kështu që konkluzionet tona të jenë në përputhje me konkluzionet e këtij dokumenti².

Kostoja e përlllogaritur në total e opsionit të preferuar mbi buxhetin e shtetit gjatë periudhës 3-vjeçare menjëherë pas miratimit të ligjit (kostoja në total në lek, çmimet aktuale, në terma nominalë):

Viti 1	Viti 2	Viti 3
0	0	0

Aktualisht, sipas të dhënave për vitin 2024, institucionet e varësisë së Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural kanë realizuar një total prej 90.3 milion lekësh të ardhura për buxhetin e shtetit. Këto të ardhura burojnë nga disa zëra kryesorë: 1.5 milion lekë nga licencat dhe lejet për shoqëritë private që operojnë në fushën e mbrojtjes së bimëve dhe veterinarisë, 37.3 milion lekë nga gjomat dhe urdhër-zhdëmtimet, 3.5 milion lekë nga

² <https://eur-lex.europa.eu/eli/reg/2017/625/oj/eng>

taksat e regjistrimit, pullat dhe tarifat e tjera shoqëruese, 5.8 milion lekë nga shitjet dhe veprimtaritë e drejtpërdrejta si analizat kimike-biologjike, si dhe rreth 42.2 milion lekë nga kamatëvonesat, pagesat për shërbime dhe certifikatat veterinare.

Ky nivel i të ardhurave është rezultat i detyrimeve financiare të vendosura mbi bizneset, të cilat janë të përcaktuara edhe në Udhëzimin nr. 19, datë 11.11.2022 *“Për tarifat e të ardhurave dytësore të aplikueshme nga institucionet vartëse të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural”*. Ky udhëzim ka shërbyer si bazë për përcaktimin e tarifave ekzistuese, duke përfshirë pagesat për licenca, leje, gjoba, tarifa shërbimesh, regjistrime, analiza laboratorike dhe certifikata veterinare. Si i tillë, ai ka qenë një instrument i rëndësishëm për standardizimin e tarifave dhe për gjenerimin e të ardhurave të qëndrueshme në buxhetin e shtetit.

Në këtë kuadër, projektligji i ri për kontrollet zyrtare pritet të ndikojë pozitivisht në të ardhurat publike, pasi parashikon që një pjesë e kontrolleve të kryhen me pagesë minimale nga operatorët ekonomikë, duke sjellë një rritje hipotetike prej rreth 5% të të ardhurave vjetore. Ky ndryshim nuk përfshin kosto shtesë për buxhetin e shtetit, pasi zbatimi i ligjit do të mbështetet në strukturat ekzistuese administrative, laboratorike dhe njerëzore të institucioneve vartëse, të cilat tashmë janë në proces riorganizimi dhe modernizimi.

Si rezultat, megjithëse Opsioni 1 paraqet një rritje të moderuar të kostove për operatorët ekonomikë, ai përmirëson ndjeshëm sistemin ligjor dhe administrativ të kontrolleve, garanton përafrim me rregulloren e Bashkimit Evropian, si dhe rrit transparencën dhe vetëfinancimin e institucioneve përgjegjëse.

KONSTULTIMI

Jepni një përmbledhje të cdo konsultimit të kryer (me kë dhe si jeni konsultuar), cfarë pikëpamjesh janë shprehur, si janë trajtuar ato, domethënë cfarë ndryshimesh janë pranuar dhe cfarë janë refuzuar dhe arsyet pse)

Kohëzgjatja e konsultimeve publike ka zgjatur nga data 19.8.2025 deri më 16.9.2025, për 20 ditë pune, afat i cili përfshin konsultimin përmes Regjistrimit Elektronik, ku gjatë publikimit pati komunikime përmes postës elektronike nga një grup interesi. Numri i shikimeve në RENJKP është 668, ku pati sugjerime nëpërmjet postës elektronike. Gjithashtu u organizua një takim me grupet e interesit në MBZHR me datë 14.10.2025, me pjesëmarrës: si INCA shpk, Shoqata BIO, BTSH, ERZENI shpk, Shoqata “ADAMA”, Shoqata Industria Përpunimit Qumështit, Shoqata BDQ etj.

Metodat e konsultimit të përdorura ishin:

- konsultimi elektronik, përmes Regjistrimit Elektronik, REKNJP, nga data 30.7.2025 deri në datën 27.8.2025;
- takim fizik në ambjentet e MBZHR datë 14.10.2025.
- komunikimi përmes postës elektronike me grupet e interesit.

Palët e interesuara të cilët kanë dhënë komente/kontribute në konsultimin publik, gjatë procesit të hartimit, kanë paraqitur komente si në vijim:

- Grupi EHË Z. Luan Leka: “Në këtë draft shkruhet që “ ky ligj është përafruar pjesërisht me rregulloren e BE 625/2017”. Përafrimi pjesërisht, në gjykimin tonë lë shumë hapësirë për rishikime. Kjo bëhet më imperative në situatën e vendit tonë, i cili ka objektiv prioritar

anëtarësimin në BE, proces i cili ka në bazë unifikimin e ligjeve. Mendojmë që nuk mund të bëhet jashtë këtij prioriteti ky ligj bazë për sigurinë ushqimore. Për këtë arsye do të propozonim së pari: “Përputhjen e ligjit me rregulloren e BE 625/2017

Lidhur me këtë koment Ministria mban qëndrimin se nuk pranohet me argumentin: “Projektligji nuk ka përafuar dispozitat e Rregullores (BE) 2017/625 të cilat janë detyrime për vendet anëtare dhe nuk janë të zbatueshme për Shqipërinë përpara anëtarësimit. Ky quhet përafrim i pjesshëm i rregullores në legjislacionin kombëtar”.

- Grupi EHË Z. Luan Leka: “Kuptojmë që për të realizuar këtë përputhje nevojitet rishikimi i shumë rregulloreve të BE të cilat ne i kemi implemetuar me ndryshime dhe sidomos pasurimin e legjislacionit me rregullore të BE që na mungojnë, konsiderojmë përkthimin e tyre si hapin e radhës për të plotësuar këtë ligj”

Lidhur me këtë koment Ministria mban qëndrimin se nuk pranohet me argumentin: “Ky projektligj është i ndërlidhur me të gjitha ligjet në fushën e ushqimit, veterinarisë dhe mbrojtjes së bimëve duke unifikuar procedurat e kontrollit zyrtar përgjatë të gjithë zinxhirit agro-ushqimor. Për këtë qëllim janë miratuar dy ligje të reja për shëndetin e bimëve dhe shëndetin e kafshëve dhe ka filluar ose do të filloj brenda vitit 2025 draftimi i ligjeve të tjera sektorale në përputhje me paketën e acquis. Synimi është që implementimi i ligjit për kontrollin zyrtar dhe ligjeve të reja sektorale të filloj në të njëjtën kohë”.

- Grupi EHË Z. Luan Leka: “Në shumë nene të këtij ligji shprehet që “ministri me udhëzim miraton aktin nënligjor”. Në rastin e implementimit të rregulloreve të BE (të rishikuara apo të reja) mendojmë që do të ishte e drejtë të shkruhej se cilës rregullore do i referohej udhëzimi i ministrit (kjo për të mos prodhuar akte nënligjore të ndryshme nga ato të BE”.

Lidhur me këtë koment Ministria mban qëndrimin se nuk pranohet me argumentin: “ - Grupi i punës që ka punuar për hartimin e këtij projektligji ka identifikuar të gjitha rregulloret evropiane që do të përafrohen dhe që janë cituar në nenet respektive duke shmangur hartimin e akteve nënligjore të ndryshme nga BE”.

- Grupi EHË Z. Luan Leka:” Për të mundur sa më sipër mendojmë që, nisur nga domosdoshmëria e këtij ligji të shpejtohet koha e hyrjes në fuqi dhe e kompletimit me aktet nënligjore. Do të ishte optimale nëse ligji në formën ekzistuese të hynte në fuqi në Janar të vitit 2026. Gjatë vitit 2026 të plotësohen aktet nënligjore që mungojnë konform rregulloreve të BE. Përse kërkojmë hyrjen në fuqi sa më shpejt të këtij ligji? Po i referohemi disa neneve të ligjit që do të shërbenin konsumatorëve dhe operatorëve të biznesit. a) Neni 42-44 Përcaktimi i produkteve që duhet të shoqërohen me certifikata sigurie dhe ato që nuk kërkojnë certifikate (urdhëri aktual Nr.374 krijon konfuzion) b) Neni 45 pika 2, Përditësimi i listës së produkteve ushqimore dhe për kafshë që i nënshtrohen kontrollit në pikat kufitare (nuk e kemi të përditësuar). c) Neni 5 pika 6, Trajnimi i stafit për të kryer kontrollin zyrtar (do të ishte më i plotë nëse do të përcaktoheshin edhe kriteret e zgjedhjes) d) Neni 8 Përcaktohet detyrimi për mos informimin e palëve të treta për rezultatet e kontrolleve duke eliminuar praktikën e dëmshme të zbatuar në mjaft raste nga AKU të cilat kanë dëmtuar operatorët e biznesit dhe kanë krijuar panik ndër konsumatorët (shpesh pa vend). e) Neni 33 Legjitimohet opinion i dytë nga ekspertë të pavarur i kërkuar nga operatori i biznesit. f) Neni 32 pika 5, Përcakton mënyrën e marrjes së mostrës për kontroll, etiketimin dhe ruajtjen, në mënyrë që të ketë vlerë ligjore. Ndërkohë mendojmë që ka vend për ndonjë korigjim si psh: g) Neni 97 Duhet të shtohet “ Nuk zbatohet për importet nga BE, mbasi Shqipëria po bën legjislacion konform BE”.

Lidhur me këtë koment Ministria mban qëndrimin se nuk pranohet me argumentin: “Sqarojmë se propozimi nuk mund të merret parasysh referuar edhe sqarimit të dhënë në pikën 2. Hyrja në fuqi e këtij ligji përpara miratimit të ligjeve sektorale çon në paralizimin

e kryerjes së kontrolleve zyrtare si rezultat i shfuqizimit që ky ligj i bën neneve që lidhen me kontrollin në të gjitha ligjet sektorale. Në të njëjtën kohë, hyrja në fuqi e ligjit me aktet nënligjore të pamiratuara do e bënte të pazbatueshëm atë. Për këtë arsye krahas identifikimit të akteve të acquis që do të përafrohen është bërë edhe një plan për përgatitjen e tyre me qëllim miratimin menjëherë pas miratimit të ligjit. Një pjesë e tyre është përfshirë edhe në Planin e Rritjes.

Gjithashtu Rregullorja 2017/625 të cilën ka përafuar projektligji për kontrollet zyrtare zbatohet në mënyrë të unifikuar në të gjitha vendet anëtare të BE-së. Periudha përpara anëtarësimit në BE nuk është vetëm për përafrimin e legjislacionit me BE-në por edhe për implementimin e tij njësoj si të gjitha shtetet anëtare me qëllim që ditën e anëtarësimit Shqipëria të jetë e barabartë me të gjitha shtetet e tjera anëtare.

ZBATIMI DHE MONITORIMI

Si do të organizohen zbatimi dhe monitorimi?

Zbatimi i opsionit të zgjedhur do të realizohet në përputhje me dispozitat përcaktuese të këtij projektligji siç vijon:

- a) Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
- b) IPKZ – Institucioni Përgjegjës për Kryerjen e Kontrollit Zyrtar;
- c) IPAT – Institucioni Përgjegjës për Aktivitete të Tjera Zyrtare;
- d) IPKPKK – Institucioni Për Kontrollin Zyrtar në Pikat Kufitare.

1. IPKZ – Institucioni Përgjegjës për kryerjen e kontrollit zyrtar

Detyrat

IPKZ është parashikuar si baza e zbatimit praktik të projektligjit. IPKZ merr përsipër të kryejë të gjitha kontrollet zyrtare drejt operatorëve në fushat e sigurisë ushqimore, shëndetit dhe mirëqenies së kafshëve, shëndetit të bimëve dhe produkteve për mbrojtje bimore. Këto kontrolle përfshijnë të gjitha fazat prej prodhimit e deri te shpërndarja duke ndjekur parimin e *vlerësimit mbi bazë risku* dhe pa njoftim paraprak, për të garantuar integritetin dhe efektivitetin e sistemit kontrolues.

Monitorimi

Mbikëqyrja kryhet nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR) përmes raporteve të rregullta dhe auditimeve teknike e administrative. Kjo marrëdhënie kontribuon në përmirësimin e cilësisë dhe efektivitetin institucional në baza periodike.

2. IPAT – Institucioni Përgjegjës për aktivitete të tjera zyrtare

Detyrat

IPAT merr përsipër një gamë të rëndësishme veprimesh që mbështesin kontrollin zyrtar: verifikim dokumentacioni, auditime shtesë, vlerësime ligjore të situatave, dhe ndihmë administrative. Ky institucion përbën një segment komplementar, duke mbuluar ato aktivitete zyrtare që nuk përfshihen në procedurat standarde të kontrollit zyrtar .

Monitorimi

MBZHR monitoron IPAT përmes kontrollit teknik dhe administrativ, me fokus *cilësia dhe objektiviteti* i raporteve të paraqitura nga IPAT. Kjo strukturë mbikëqyrëse siguron që IPAT të funksionojë në përputhje me standardet administrative të vendosura .

3. IPKPKK – Institucioni Për Kontrollin Zyrtar në Pikat Kufitare

Detyrat

IPKPKK është përgjegjës për kontrollet zyrtare në pikat kufitare, duke përfshirë ushqimet, bimët, kafshët, inputet bujqësore dhe produktet për mbrojtje bimore që

depërtojnë ose eksportohen. Ky institucion siguron që hyrja/dalja e këtyre produkteve të jetë në përputhje me legjislacionin në fuqi .

Monitorimi

IPKPKK zhvillon aktivitet në bashkëpunim të ngushtë me doganat dhe agjencitë e tjera kufitare dhe raporton drejtpërdrejt te MBZHR. Ky mekanizëm siguron koordinim ndërinstytucional dhe mbikëqyrje të qartë funksionale .

4. MBZHR – Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (Autoriteti Qendror)

Detyrat

MBZHR është autoriteti qendror që koordinon, monitoron dhe raporton për të gjithë mekanizmin e ri të kontrollit zyrtar. MBZHR:

- Koordinon funksionimin e IPKZ, IPAT dhe IPKPKK;
- Verifikon dhe analizon raportet dhe auditimet nga këto institucione;
- Siguron përputhjen me standardet ligjore dhe kërkesat e integritetit evropian (Kapitujt 11 & 12);
- Raporton në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar për zbatimin e legjislacionit në fushat përkatëse.

Monitorimi

MBZHR ka funksionin të dyfishtë monitorimi ku në njërin anë mbikëqyr zbatimin e ligjit nga vet institucionit dhe në anën tjetër mbikqyr institucionet që ka nën varësi. Konkretisht kryen këto detyra:

- Mbledh të dhëna dhe raporte nga institucionet e reja;
- Kryen auditime dhe analiza cilësore;
- Informon Komisionin Evropian dhe institucionet e tjera për avancimin në zbatim ligjor (përfshirë monitorimin e sigurisë ushqimore, veterinarinë dhe mbrojtjen e bimëve).

PJESA 2: BAZA KRYESORE E ANALIZËS DHE E PROVAVE

Historik

Jepni kontekstin e politikës

Integrimi i Shqipërisë në Bashkimin Evropian dhe Sfidat në Sektorin Agroushqimor

Potenciali i Shqipërisë si vend i Ballkanit Perëndimor për t'u anëtarësuar në Bashkimin Evropian u evidentua për herë të parë në Samitin e Këshillit Evropian të zhvilluar në Selanik në vitin 2003. Ky moment shënoi fillimin e një rruge të gjatë drejt integritetit, që përfshinte përmbushjen e një sërë kriteresh politike, ekonomike dhe ligjore.

Në tetor të vitit 2012, Komisioni Evropian rekomandoi që Shqipërisë t'i jepet statusi i kandidatit për anëtarësim në BE. Pas dy vitesh, në qershor 2014, Shqipëria fitoi zyrtarisht statusin e vendit kandidat. Në prill 2018, Komisioni miratoi një rekomandim të pakushtëzuar për hapjen e negociatave të anëtarësimit. Këshilli Evropian në qershor të po atij viti përcaktoi kushtet që duheshin përmbushur për hapjen e negociatave në qershor 2019, duke theksuar progresin në fusha si gjyqësori, lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, shërbimet e inteligjencës dhe administrata publike.

Në Paketën e Zgjerimit të majit 2019, Komisioni përsëriti rekomandimin për hapjen e negociatave, dhe Këshilli Evropian e mori këtë parasysh në konkluzionet e tij të qershorit të po atij viti. Më pas, në mars 2020, u miratua vendimi për hapjen e negociatave nga

Këshilli i Çështjeve të Përgjithshme. Në korrik 2020, Shqipërisë iu prezantua drafti i kuadrit negociator. Konferenca Ndërqeveritare e mbajtur në korrik 2022 shënoi një tjetër hap të rëndësishëm, kurse Komisioni filloi menjëherë procesin e shqyrtimit (screening), i cili po ecën pa probleme deri më tani.

Integrimi i sektorit agroushqimor: më shumë se harmonizim

Ashtu si çdo sektor tjetër, integrimi i bujqësisë në kuadër të procesit të anëtarësimit në BE nuk është një veprim i menjëhershëm apo thjesht një kërkesë teknike; është një proces kompleks që kërkon përgjegjësi të lartë sociale dhe ekonomike. Ai nënkupton jo vetëm përfitime dhe investime, por edhe zbatimin e një sërë rregullash dhe standardesh, të cilat duhet të përmbushen për të siguruar akses të plotë e të pakufizuar në tregun e përbashkët evropian.

Shëndeti i bimëve dhe kërcënimet nga tregtia globale

Ashtu si edhe vendet e tjera të BE-së, Shqipëria përballlet me sfida që paraqesin rreziqe shtesë si pasojë e globalizimit të tregtisë, rritjes së importeve dhe ndryshimeve klimatike. Këta faktorë kontribuojnë në përhapjen e dëmtuesve të rinj të bimëve, të cilët mund të shfaqen duke kërcënuar ekosistemet bujqësore dhe natyrore të vendit.

Sistemi i shëndetit të bimëve në Shqipëri është në proces të vazhdueshëm përshtatjeje, me qëllim modernizimin, parandalimin e rreziqeve, planifikimin e mirë të ndërhyrjeve, si dhe harmonizimin me standardet evropiane, për të garantuar akses në tregun e BE-së.

Në këtë kuadër, është miratuar Ligji Nr. 40/2025 “Për shëndetin e bimëve”, që përmbush kërkesat e Bashkimit Evropian të shprehura në raportet e progresit të dy viteve të fundit.

Edhe pse Rregullorja solli përmirësime të dukshme në mënyrën si organizohen dhe zbatohen kontrollet, vlerësimet e bëra nga autoritetet kombëtare dhe auditimet e Komisionit Evropian kanë nxjerrë në pah mangësi të rëndësishme. Këto mangësi lidhen me faktin se disa nga parimet dhe objektivat e Rregullores nuk janë zbatuar plotësisht dhe se qasja e integruar ndaj kontrolleve zyrtare është vendosur vetëm pjesërisht.

Për të adresuar këto dobësi dhe për të siguruar një sistem më të fortë e të unifikuar, Bashkimi Evropian ka ndërmarrë një rishikim të kësaj rregulloreje, si pjesë e një pakete më të gjerë reformash që përfshin gjithashtu legjislacionin për shëndetin e kafshëve, shëndetin e bimëve dhe materialet riprodhuese bimore. Synimi i këtij rishikimi është të modernizojë dhe të integrojë më tej sistemin e kontrolleve zyrtare, në përputhje me zhvillimet e reja dhe me nevojën për të mbrojtur më mirë shëndetin publik, sigurinë ushqimore dhe mjedisin në të gjithë Bashkimin Evropian.

Në përfundim është pikërisht Rregullorja Evropiane (BE) 2017/625 “Mbi kontrollet zyrtare dhe aktivitetet e tjera zyrtare të kryera për të siguruar zbatimin e ligjit për ushqimin dhe ushqimin për kafshët, rregullat për shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve, shëndetin e bimëve dhe produktet për mbrojtjen e bimëve” ajo që u miratua dhe përshiu në dispozitat e saj ligjore të gjithë fushat problematike lidhur me ushtrimin e kontrolleve zyrtare duke i dhënë fund kështu njëkohësisht edhe fragmentizimit të kuadrit ligjor.

Deri më tani në fushën e sigurisë ushqimore është operuar në bazë të një kuadri legjislativ si në vijim:

➤ Ligje

1. Ligji Nr 1944 dt 11.11.2005 “Për prodhimin grumbullimin dhe tregëtimin e qumështit dhe të produkteve me bazë qumështi”, i ndryshuar;
2. Ligj Nr. 9863 dt 28.1.2008 “Për ushqimin” i ndryshuar;

3. Ligj Nr. 87/2013 “Për kategorizimin e prodhimit, emertimin dhe tregëtimin e vajit të ullirit dhe vajit të bërsisë së ullirit.

➤ **Vendime të Këshillit të Ministrave**

1. Vendim Nr. 304, datë 9.5.2012 “Për përbërjen dhe detyrat e Komisioneve të Regjistrimit të Përgjithshëm të Njësive Ekonomike Bujqësore në Bashki dhe Komuna”;
2. Vendim Nr. 551, datë 22.8.2012 “Për miratimin e kriterëve për përzgjedhjen, rekrutimin e trajnimit të personelit të regjistrimit, si dhe përcaktimin e detyrave të përgjegjësisë të personelit të Regjistrimit të Përgjithshëm të Njësive Ekonomike Bujqësore”;
3. Vendim i Këshillit të Ministrave Nr 1344 dt 10.10.2008 “Për miratimin e rregullave “Për etiketimin e produkteve ushqimore”;
4. Vendim i Këshillit të Ministrave Nr 760 dt 16.9.2015 “Për kërkesat për gjurmimin e ushqimit dhe ushqimit për kafshë përgjatë zinxhirit ushqimor”;
5. Vendim i Këshillit të Ministrave Nr 406 dt 20.5.2020 “Për miratimin e rregullave “Për etiketimin e ushqimit për kafshë që përdoren për udhqim, përfshirë dhe ato që kanë në përbërje ose përmbajnë organizma të modifikuar gjenetikisht”.

➤ **Akte të tjera ligjore**

1. Urdhër Nr. 10 dt 13.1.2010 “Për vlerësimin dhe kategorizimin e stabilimenteve të produkteve ushqimore me rigjinë shtazore”;
2. Udhëzim Nr. 22 dt 25.11.2010 “Për kushtet e përgjithshme dhe të vecanta të higjenës për stabilimentet e ushqimit dhe operatorët e biznesit ushqimor”;
3. Udhëzim Nr. 23 dt 25.11.2010 “Për kërkesat specifike të higjenës për mishin dhe produktet e mishit, duke përfshirë produktet e mishit, mishin e grirë dhe mishin e ndarë, në mënyrë mekanike”;
4. Udhëzim Nr. 23 dt 25.11.2010 “Për kërkesat specifike të higjenës për mishin dhe produktet e mishit, duke përfshirë produktet e mishit, mishin e grirë dhe mishin e ndarë në mënyrë mekanike” i ndryshuar;
5. Urdhër Nr. 266 dt 29.8.2011 “Për miratimin e rregullores “Për industrializmin dhe tregëtimin e ujit” i ndryshuar;

Problemi në shqyrtim

- *Përshkruani natyrën e problemit.*
- *Identifikoni shkaqet e problemit.*
- *Përshkruani shtrirjen e problemit.*
- *Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria / biznesi / shoqëria civile / qytetarët.*
- *Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave.*

- *Përshkruani natyrën e problemit.*

Problematikat e identifikuara janë të natyrës rregullatore, kjo mbështetur në shumë shkaqe që prekin aspekte ku mund të përmëndim fragmentizimin e legjislacionit, mungesën e planifikimi në bazë risku, rëndësia dhe varësia nga buxheti i shtetit etj. Këto aspekte janë trajtuar më detajisht në vijim.

Zbatimi i legjislacionit të Bashkimit Evropian për sigurinë e zinxhirit agro-ushqimor është një detyrë themelore që u takon shteteve anëtare. Autoritetet kombëtare janë përgjegjëse për të siguruar që të gjitha kërkesat dhe standardet e vendosura nga BE-ja të respektohen në mënyrë të njëtrajtshme në të gjithë territorin e saj. Kjo përfshin verifikimin e përputhshmërisë së produkteve dhe aktiviteteve të operatorëve që vendosin mallra në treg qoftë të prodhuara brenda BE-së apo të importuara nga vende të treta – me rregullat dhe kriteret e përcaktuara.

Një nga aspektet më të rëndësishme të kësaj përpjekjeje është zhvillimi i një sistemi kontrollesh zyrtare që mbulon të gjithë zinxhirin agro-ushqimor. Të gjitha bizneset, pavarësisht madhësisë së tyre, i nënshtrohen këtyre kontrolleve dhe kur vjen fjala për ushtrimin e kontrolleve zyrtare ato duhet të organizohen në nivel rrezikut duke reflektuar riskun që aktivitetet e tyre mund të paraqesin për sigurinë ushqimore. Megjithatë shpesh besohet se bizneset më të vogla paraqesin më pak rrezik, përvoja ka treguar të kundërtën. Edhe mikro-ndërmarrjet, që përbëjnë më shumë se gjysmën e operatorëve në shumë shtete anëtare, mund të paraqesin rreziqe serioze, siç dëshmohet nga rastet e kaluara të kontaminimeve me baktere si E.Coli³.

Forcimi i sistemit rregullator agroushqimor në Shqipëri është i domosdoshëm për të përmirësuar mbrojtjen e shëndetit të konsumatorëve, të kafshëve dhe të bimëve⁴. Aktualisht, ky sistem ka disa mangësi të identifikuara, si: mungesë të të dhënave mbi incidencën e rreziqeve ushqimore dhe sëmundjeve të lidhura me to, kosto të panjohura ekonomike nga ushqimet e pasigurta, dhe mungesë vlerësimi për efikasitetin e ndërhyrjeve të bëra në këtë fushë.

Mangësitë janë të lidhura edhe me faktorë institucionalë si: fragmentarizimi i zinxhirëve të vlerës ushqimore, mbivendosja e mandateve të institucioneve publike, mungesa e përfaqësimit efektiv të konsumatorëve dhe operatorëve të biznesit ushqimor.

Për të adresuar këto sfida, është e nevojshme rritja e disponueshmërisë së të dhënave për monitorim dhe mbikëqyrje bazuar në risk, forcimi i evidencave shkencore, përmirësimi i infrastrukturës, zhvillimi i burimeve njerëzore të trajnuara, forcimi i kulturës së sigurisë ushqimore dhe përmirësimi i rregulloreve zbatuese.

Për të krijuar një sistem të përbashkët dhe të harmonizuar kontrollesh në të gjithë BE-në, u miratua Rregullorja 882/2004⁵, e cila vendosi një kuadër të përgjithshëm për mënyrën se si duhet të organizohen dhe financohen kontrollet zyrtare. Megjithatë, Rregullorja nuk përfshiu të gjithë sektorët e zinxhirit agro-ushqimor. Fusha të rëndësishme si shëndeti i bimëve, materiali riprodhues bimor dhe nënproduktet shtazore mbetën jashtë fushëveprimit

³ Impact Assessment fq. 2. <https://eur-lex.europa.eu/eli/reg/2017/625/oj/eng>

⁴ SKUU 2023-2027 fq.3

⁵ Kjo rregullore është shfuqizuar me Rregulloren Evropiane (BE) 2017/625 “Mbi kontrollet zyrtare dhe aktivitetet e tjera zyrtare të kryera për të siguruar zbatimin e ligjit për ushqimin dhe ushqimin për kafshët, rregullat për shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve, shëndetin e bimëve dhe produktet për mbrojtjen e bimëve.

të saj dhe u rregulluan përmes skemave të veçanta sektoriale. Po ashtu, kontrollet që kanë të bëjnë me shëndetin e kafshëve dhe mbetjet e barnave veterinarë vijuan të funksionojnë jashtë kornizës së përbashkët, për shkak të traditave dhe legjislacionit të mëparshëm.

Sfidat ligjore dhe ndikimi në eksportet

Një nga sfidat më të mëdha të Shqipërisë në këtë proces është mospërputhja e legjislacionit kombëtar me *acquis communautaire* të BE-së. Kjo jo vetëm që dekurajon investimet, por ndikon drejtpërdrejt negativisht në sektorin bujqësor duke penguar eksportet e ushqimeve me origjinë shtazore, çka sjell pasoja për ekonominë kombëtare.

Kostoja ekonomike e ushqimeve të pasigurta, e shpërthimeve të sëmundjeve të kafshëve dhe bimëve paraqitet në disa forma ku përfshihen humbja e produktivitet, kosto për shëndetin publik dhe ndërprerje të tregjeve ushqimore si pasojë e frikës së konsumatorëve ndaj produkteve potencialisht të rrezikshme.

Fragmentimi i legjislacionit, mungesa e një ligji gjithëpërfshirës dhe mospërafrimi i akteve të tjera ligjore pengon përparimin në përafrimin me Kapitullin 12 të *acquis* të BE-së.. Gjithashtu, mungesa e kategorizimit të sëmundjeve të kafshëve sipas prioriteteve dhe mospërputhja me standardet ndërkombëtare (p.sh. OIE – Organizata Botërore për Shëndetin e Kafshëve), përbëjnë një pengesë serioze në rrugën drejt integritetit të plotë.

Në këtë kontekst, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka miratuar Ligjin Nr. 41/2025 “Për shëndetin e kafshëve”, që përafron rregulloren (BE) 2016/429 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, të datës 9 mars 2016, duke krijuar një kornizë të re për kontrollin e sëmundjeve të transmetueshme tek kafshët.

Një nga pengesat më të mëdha që ka shoqëruar përpjekjet e Shqipërisë për të përmbushur kërkesat e *acquis communautaire* në fushën e bujqësisë, sigurisë ushqimore dhe shëndetit të kafshëve e bimëve ka qenë fragmentarizimi i legjislacionit ekzistues. Dispozitat ligjore të shpërndara në akte të ndryshme, me mbivendosje kompetencash ndërmjet institucioneve përgjegjëse dhe mungesë të një kornize të qartë strategjike, kanë krijuar vakume funksionale dhe gjatë zbatimit në sistemin rregullator. Kjo qasje e decentralizuar ka ndikuar negativisht jo vetëm në përmbushjen e standardeve të BE-së, por edhe në krijimin e një mjedisi të parashikueshëm dhe të paqëndrueshëm për investime në sektor.

Problemet kryesore të identifikuara mbi kontrollet zyrtare

1.Zbatim i pabarabartë dhe mungesë përputhjeje në sektorë të ndryshëm- Rregullorja 2017/625 synon të krijojë një sistem të përbashkët kontrollesh në të gjithë hapësirën e BE-së, duke përfshirë edhe disa sektorë të cilët ishin jashtë fushëveprimit gjë e cila ka rezultuar në mospërputhje ligjore dhe boshllëqe duke ndikuar negativisht cilësinë e kontrolleve.

2.Mungesa e analizës në bazë risku në disa kontrolle - Në disa fusha si kontrollet në kufi për mallrat nga vendet e treta dhe mbetjet e barnave veterinarë, nuk përdoret qasja e ushtrimit të kontrolleve zyrtare në programe të vlerësuara në bazë risku. Kjo ka çuar në përdorim joefektiv të burimeve dhe kontrolle të panevojshme.

3.Ngarkesë administrative për autoritetet kompetente- Shtetet duhet të paraqesin plane

dhe raporte të shumta, shpesh të dyfishta, për shkak të kuadrit rregullator të vjetër dhe të pa përditësuar sipas legjislacionit në fuqi të BE-së.

4.Kufizime për laboratorët zyrtarë - Legjislacioni aktual nuk parashikon fleksibilitet për raste emergjente apo për laboratorët e vegjël, çka e vështirëson punën e tyre në kushte të veçanta.

5.Bashkëpunim i kufizuar mes autoriteteve -Edhe pse ushtrimi i kontrolleve zyrtare kërkon bashkëpunim mes shteteve dhe autoriteteve të ndryshme, në praktikë kjo nuk ndodh plotësisht për shkak të mungesës së udhëzimeve të qarta dhe rregullave të detajuara e të përcaktuara qartë.

6. Mungesa e burimeve financiare- Autoritetet kompetente, si në Shqipëri ashtu edhe në vendet e BE-së, përballen me vështirësi të vazhdueshme në sigurimin e financimit për kontrollet zyrtare. Raportet e auditeve kanë theksuar se shumë mangësi në kontrolle lidhen me mungesën e fondeve. Përafrimi me Rregulloren 2017/625 synon të adresojë këtë problem duke siguruar kuadër të qartë ligjor dhe burime të qëndrueshme financiare për një zbatim efektive duke ngarkuar OB me tarifa per kryerjen e ketyre kontrolleve. Shtetet iu është lënë hapësirë për të zgjedhur tarifat për kontrollet zyrtare dhe kush do të ngarkohet me tarifë ose jo.

Si preken grupet e interesit nga problematikat e paraqitura

1.Qeveria

Qeveria përballen me sfida në përmbushjen e detyrimeve për përafrimin me legjislacionin e BE-së, për shkak të boshllëqeve ligjore, burimeve të kufizuara financiare dhe kapaciteteve të pamjaftueshme për zbatim të barabartë e efektiv të kontrolleve. Kjo ul besueshmërinë e institucioneve dhe rrezikon përfitimin e mbështetjes nga BE.

2.Fermerët

Fermerët përballen me kontrolle të pabarabarta dhe shpesh të panevojshme, duke humbur kohë dhe resurse. Mungesa e një qasjeje të bazuar në rrezik i vendos ata nën barrë administrative, edhe kur aktiviteti i tyre nuk paraqet rrezik të lartë.

3.Shoqëria civile

Mungesa e transparencës dhe e informimit të duhur për aktivitetet e kontrollit ul mundësinë e shoqërisë civile për të monitoruar sektorin agro-ushqimor dhe për të mbrojtur interesin publik, sidomos në fushat e sigurisë ushqimore dhe mjedisit.

4.Prodhuesit e blegtorisë

Edhe ata ndihen të penalizuar nga kontrolle që nuk janë të unifikuara dhe jo gjithmonë të justifikuara nga analiza e riskut. Mungesa e mbështetjes financiare për autoritetet i ekspozon këta prodhues ndaj kontrolleve të mangëta ose të fragmentuara, që mund të ndikojnë në standardet e prodhimit.

5.Industria përpunuese/prodhuese e produkteve me origjinë shtazore

Këto industri përballen me pasiguri ligjore dhe mungesë koherence në kontrolle. Kjo ndikon në cilësinë e produkteve, rrit kostot e pajtueshmërisë dhe ul mundësinë e eksportit, pasi standardet nuk janë të njëjta me ato të BE-së.

6.Punëmarrësit

Punonjësit e përfshirë në sektorët e kontrolluar preken nga pasiguria që sjellin praktikën e pabarabarta dhe mungesa e standardeve të qarta. Mungesa e burimeve ndikon edhe në kapacitetin e inspektorëve dhe të stafit teknik për të kryer detyrat në mënyrë efikase dhe të sigurt.

Grupet e prekura nga problemi

- Qeveria;
- Fermerët;
- Shoqëria civile;
- Prodhuesit e blegtorisë;
- Industria përpunuese/prodhuese e produkteve me origjinë shtazore;
- Punëmarrësit.
- Operatorët e bizneseve;

Perfundimisht, problemi i identifikuar mund të trajtohet vetëm përmes ndryshimit të politikave duke hartuar një kornizë solide të vetme ligjore.

Arsyeja e ndërhyrjes

- *Shpjegoni pse qeveria planifikon të ndërhyjë dhe pse është e nevojshme.*
- *Shpjegoni pse qeveria planifikon të ndërhyjë dhe pse është e nevojshme.*
- *Identifikoni shkallën e ndërhyrjes së qeverisë që nevojitet për të trajtuar problemin*
- *Rendisni punën egzistuese që është realizuar tashmë.*

Nëpërmjet kësaj nisme synohet të plotësohet nevoja për një kuadër të harmonizuar ligjor për kontrollet zyrtare në zinxhirin agro-ushqimor. Ekzistenca e një kuadri të përbashkët ligjor në nivel të Bashkimit Evropian për organizimin dhe zbatimin e kontrolleve zyrtare përgjatë të gjithë zinxhirit agro-ushqimor mbetet thelbësore për sigurimin e një zbatimi të unifikuar të legjislacionit dhe për funksionimin e pandërprerë të tregut të brendshëm. Ky qëndrim, tashmë i konsoliduar, vazhdon të mbështesë strukturën ekzistuese ligjore të BE-së në këtë fushë.

Politika e re vjen si përgjigje ndaj këtyre sfidave duke propozuar unifikimin e kuadrit ligjor, harmonizimin e tij të plotë me normativën evropiane dhe konsolidimin institucional të zinxhirit agroushqimor duke garantuar kështu një funksionalitet të qëndrueshëm, efikasitet të lartë në zbatim dhe një bazë solide për integrimin e plotë të sektorit në tregun e përbashkët evropian.

Shqipëria duke përafruar këtë rregullore synon që jo vetëm të jetë në përputhje me standartet evropiane në aspektin ligjor dhe sigurinë ushqimore por të forcojë bazat e tregut të

brendshëm dhe të sigurojë akses të pakufizuar në atë ndërkombëtar duke dalë në përfundime të njëjta me ato të BE-së.

Megjithëse zbatimi i sistemit të kontrollit është përgjegjësi e shteteve anëtare, problemet strukturore të konstatuara në kuadrin aktual ligjor nuk mund të zgjidhen individualisht. Rishikimi i thelluar dhe përmirësimi i këtij kuadri kërkon ndërhyrje të drejtpërdrejtë nga ligjvënësi shqiptar, për të garantuar një qasje të përbashkët europiane, të qëndrueshme dhe të qëndrueshme në afatgjatë.

Një nga përfitimet kryesore të një kornize të unifikuar në nivel të BE-së është se ajo ofron siguri juridike dhe operacionale për autoritetet kompetente dhe operatorët ekonomikë. Kjo kornizë mundëson që rezultatet e kontrolleve të kryera në një shtet anëtar të pranohen dhe të përdoren nga autoritetet e një shteti tjetër, duke forcuar kështu besueshmërinë teknike dhe shkencore të sistemit dhe duke shmangur duplikimin e përpjekjeve.

Një sistem funksional dhe i besueshëm i kontrollit zyrtar është gjithashtu kyç për pozitën tregtare të Shqipërisë, si në eksport ashtu edhe në import. Eksportet e vendit tonë varen nga reputacioni i standardeve të larta të sigurisë dhe cilësisë, të cilat mund të garantohet vetëm përmes një sistemi efikas kontrolli. Në të njëjtën kohë, kontrollet mbi produktet e importuara nga vendet e treta janë thelbësore për të garantuar që të gjitha produktet që hyjnë në tregun e e RSH-së përmbushin standardet e sigurisë dhe cilësisë të barasvlefshme me ato të prodhuara në BE.

Sa i takon aspektit financiar, rregullat e përbashkëta të BE-së luajnë një rol vendimtar në sigurimin e qëndrueshmërisë së sistemit të kontrollit. Ato mundësojnë një burim të besueshëm financimi për autoritetet kompetente, në përputhje me nivelin e rrezikut dhe nevojat për zbatim. Në këtë kontekst, parimi "përdoruesi paguan" siguron që subjektet ekonomike që përfitojnë drejtpërdrejt nga kryerja e kontrolleve të kontribuojnë në mbulimin e kostove përkatëse. Kjo ndihmon në uljen e varësisë nga financat publike dhe përforcon qëndrueshmërinë e sistemit.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm është nevoja për të shmangur praktikën e pabarabarta ndërmjet shteteve anëtare. Në mungesë të një rregullimi të përbashkët, mund të ndodhin diferencime të padrejta në trajtimin e operatorëve ekonomikë, në varësi të vendit të tyre të veprimtarisë. Vetëm një kuadër i harmonizuar në nivel të BE-së mund të sigurojë trajtim të drejtë dhe të barabartë për të gjithë operatorët në tregun e brendshëm.

Në funksion të proporcionalitetit, analiza e zhvilluar ka shqyrtuar disa opsione të mundshme – nga harmonizimi i tarifave në nivel të BE-së, deri te lënia e plotë e çështjes në dorë të shteteve anëtare. Zgjidhja e propozuar synon të jetë e balancuar: të sigurojë një fluks të qëndrueshëm dhe të mjaftueshëm të burimeve për kontrollet zyrtare, duke u dhënë njëkohësisht shteteve fleksibilitetin e nevojshëm për të rregulluar mekanizmat e brendshëm sipas kushteve specifike të tregut dhe kapaciteteve vendore⁶.

Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.

Ky dokument shoqëruar synon të ofrojë një pasqyrë të plotë dhe të qartë mbi arsyetimin strategjik dhe ligjor që qëndron pas propozimit të ligjit paraqitur për shqyrtim në Këshillin e Ministrave. Ai ka për qëllim të informojë në mënyrë të thelluar dhe të argumentuar

⁶ Impact Assessment fq.6

vendimmarrësit mbi nevojën e këtij ndryshimi ligjor, duke nxjerrë në pah rëndësinë e tij për harmonizimin e kuadrit legjislativ me standardet ndërkombëtare dhe kërkesat e integritit evropian.

Dokumenti gjithashtu paraqet analizën e ndikimit, duke vlerësuar përfitimet e pritshme në përmirësimin e efikasitetit dhe transparencës së mekanizmave të kontrolleve zyrtare, dhe duke nënvizuar kontributin e kësaj reforme në forcimin e besueshmërisë së institucioneve shtetërore dhe sigurinë ushqimore për qytetarët dhe bizneset.

Përmes këtij teksti, synohet të krijohet një kuadër i qartë dhe i qëndrueshëm për vendimmarrjen, duke siguruar një bazë të fuqishme për zbatimin e politikave në dobi të zhvillimit ekonomik, shëndetit publik dhe integritit harmonik të vendit në Bashkimin Evropian. Kjo qasje synon të mbështesë dialogun institucional dhe bashkëpunimin ndërmjet aktorëve kryesorë në sektor, duke garantuar një tranzicion të qëndrueshëm drejt standardeve më të larta ligjore dhe administrative.

Lidhja ndërmjet politikës së kontrolleve zyrtare dhe dokumenteve strategjike kombëtare dhe rajonale

Politika për harmonizimin dhe forcimin e kontrolleve zyrtare në zinxhirin agro-ushqimor është në përputhje të plotë dhe mbështetet fort nga një sërë strategjish dhe dokumentesh të rëndësishme kombëtare dhe rajonale, të cilat synojnë zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit bujqësor, sigurimin e ushqimit dhe integrimin evropian të vendit.

1. Strategjia për bujqësinë, zhvillimin rural dhe peshkimin 2021-2027 (Vendimi Nr. 460, datë 29.06.2022)

Kjo strategji fokusohet në përmirësimin e cilësisë dhe sigurisë së produkteve bujqësore dhe peshkimi, si dhe në forcimin e qëndrueshmërisë së zonave rurale. Harmonizimi i kontrolleve zyrtare ndihmon në garantimin e standardeve të BE-së për sigurinë ushqimore dhe shëndetin e kafshëve dhe të bimmëve, elementë kyç të strategjisë për rritjen e konkurrencës së produkteve shqiptare në tregjet vendase dhe ndërkombëtare.

2. Plani Kombëtar për Integrimin Evropian 2024 (Vendimi Nr. 16, datë 11.01.2024): Ky plan përcakton angazhimet për përafrimin e legjislacionit shqiptar me acquis-në e BE-së në fusha të ndryshme, përfshirë sigurinë ushqimore dhe kontrollin zyrtar. Politika e unifikimit të kontrolleve zyrtare është një element kyç për të përmbushur kërkesat e këtij plani dhe për të avancuar procesin e anëtarësimit në BE.

3. Strategjia Kombëtare për Sigurinë Ushqimore 2023 – 2027 (Vendimi Nr. 366, datë 16.06.2023):

Siguria ushqimore është një prioritet kryesor i strategjisë kombëtare. Kontrolli zyrtar i harmonizuar dhe i bazuar në analizë risku ndihmon në kontrollin e rrezikut për konsumatorët dhe garanton cilësinë e ushqimeve të prodhuara dhe të importuara, duke kontribuar direkt në realizimin e objektivave të sigurisë ushqimore.

4. Programi i Qeverisë

Programi qeverisës thekson nevojën për përmirësimin e administratës publike dhe forcimin e kapaciteteve institucionale. Një sistem efikas dhe i harmonizuar kontrolli zyrtar është pjesë integrale e këtyre synimeve, duke garantuar një menaxhim më të mirë të burimeve dhe përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve dhe bizneseve.

5. Agjenda e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor

-Në linjë me Marrëveshjen e Gjelbër Evropiane, Shqipëria ka marrë angazhime të plota në kuadër të Agjendës së Gjelbër për Ballkanin Perëndimor. Me nënshkrimin e kësaj agjende, Shqipëria u angazhua për të ndjekur strategjinë e BE-së “Nga ferma në tavolinë” dhe për të promovuar praktika që kontribuojnë në neutralitetin klimatik, efikasitetin e përdorimit të burimeve dhe konkurrueshmërinë e sektorit agrorushqimor. Objektivat përfshijnë reduktimin e përdorimit të pesticideve dhe antimikrobikëve, zvogëlimin e plehërimit të tepërt, zhvillimin e bujqësisë organike, rritjen e mirëqenies së kafshëve dhe mbrojtjen e biodiversitetit⁷. Kjo agjendë promovon zhvillimin e qëndrueshëm, përfshirë menaxhimin e burimeve natyrore dhe sigurimin e produkteve ushqimore cilësore dhe të sigurta. Harmonizimi i kontrolleve zyrtare dhe përputhja me standardet evropiane mbështet direkt qëllimet e Agjendës, duke kontribuar në tranzicionin e qëndrueshëm mjedisor dhe ekonominë rrethore në rajon.

Përmbyllje

Propozimi i kësaj politike dhe nismat e ndërmarra nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural përbëjnë një hap të rëndësishëm në përmbylljen e kushteve për integrimin në BE. Këto masa përfaqësojnë jo vetëm përputhje me normat ligjore të Unionit, por edhe një përkushtim strategjik për transformimin e sektorit agrorushqimor, duke garantuar konkurrueshmëri, siguri dhe qëndrueshmëri në tregjet ndërkombëtare.

Më poshtë po rendisim punën ekzistuese të kryer deri më tani:

Siguria ushqimore, shëndeti i kafshëve dhe mbrojtja e bimëve përbëjnë shtyllat kryesore të garantimit të shëndetit publik dhe zhvillimit të qëndrueshëm të sektorit bujqësor dhe ushqimor në Shqipëri. Në këtë kontekst, institucionet përgjegjëse kanë ndërmarrë hapa të rëndësishëm për të siguruar zbatimin rigoroz të legjislacionit në fuqi dhe për të ushtruar kontrolle të efektshme zyrtare në të gjitha hallkat e zinxhirit ushqimor.

Ligji në fuqi i cili rregullon këtë fushë është Ligji Nr. 10137, datë 11.05.2009, “Për Ushqimin”. Ky ligj përcakton kuadrin ligjor për kontrollin dhe sigurinë e produkteve ushqimore nga prodhimi deri te konsumatori përfundimtar. Ai vendos standarde të qarta për prodhimin, përpunimin, tregtimin dhe kontrollin e ushqimeve, si dhe për shëndetin e kafshëve dhe mbrojtjen e bimëve.

Zbatimi i këtij kuadri ligjor realizohet nga një sistem i strukturuar institucional, ku ndërgjegjësimi dhe përgjegjshmëria janë kompetenca të:

- *Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU):* Institucioni kryesor përgjegjës për kontrollin zyrtar të sigurisë ushqimore dhe mbrojtjen e konsumatorit. AKU operon me një rrjet të gjerë inspektimesh në pikat kufitare dhe laboratorë rajonalë, duke garantuar analiza të thelluara dhe monitorim të vazhdueshëm të produkteve ushqimore.
- *Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV):* Ky institut kryen analiza laboratorike të specializuara, duke mbështetur me ekspertizë shkencore të avancuar procesin e vlerësimit dhe kontrollit të produkteve ushqimore dhe veterinare.
- *Drejtoria Rajonale të Bujqësisë:* Përgjegjëse për monitorimin në terren të produktit primar me origjinë shtazore dhe bimë, në bashkëpunim me strukturat e pushtetit vendor.

⁷ SBZRP fq.13

Mekanizmat e Kontrollit dhe Masat Ndëshkuese- Kontrollët zyrtarë zhvillohen kryesisht pë njoftim paraprak, duke u bazuar në një vlerësim të detajuar të riskut, që merr parasysh natyrën e produktit, historikun e operatorit dhe rreziqet e mundshme për shëndetin publik. Në rastet kur konstatohet shkelje, ndërmerren masa administrative, përfshirë ndërprerjen e menjëhershme të aktivitetit të operatorit deri në plotësimin e kërkesave ligjore.

Inspektimet në terren dhe PIK⁸ gjatë viti 2024

AIKKU gjatë periudhës janar-dhjetor të vitit 2024 realizoi gjithsej 111,785 inspektime nga të cilat 32,047 inspektime në terren si dhe 79,315 inspektime me një përqinje realizimi si total inspektime të kryera prej 109,3%. Kontrollët zyrtarë të realizuara në terren konsistojnë në 25,258 të programuara sipas planit vjetor të kontrolleve zyrtare me bazë risku dhe 6,789 të paprogramuara. Në nivel kombëtar rezulton që plani vjetor i inspektimeve është realizuar në masën 86,2%.

Masa administrative në terren gjatë vitit 2024

Për OBU të cilët nuk kanë plotësuar standartet ushqimore të parashikuara në legjislacionin në fuqi janë vendosur 3,841 masa administrative, përkatësisht:

- 3,510 paralajmërime;
- 294 gjoba me vlerë 44,670,000 lekë;
- 37 ndërprerje aktiviteti si dhe
- 248 raste bllokimesh me sasi 396,2 ton, 216,394.3 litra, 146 kokrra vezë dhe 255 copë;
- 184 raste asgjësimesh me sasi 2,012 ton, 634,966.5 litra, dhe 34 copë;
- Kthim sendi në vëndin e origjinës 31 ngarkesa me sasi 214.94 ton, 30,548.25 litra, 4,127 copë, 635 krerë dhe 200 kartona.

Inspektimet në terren dhe PIK gjatë viti 2025

AIKKU gjatë periudhës janar-qeshor të vitit 2025 realizoi gjithsej 58,849 inspektime nga të cilat 16,767 janë inspektime në terren dhe 42,082 inspektime në Pikat e Inspektimit Kufitar. Kontrollët zyrtarë të realizuara në terren konsistojnë në 13,415 të programuara sipas planit vjetor të kontrolleve zyrtare me bazë risku dhe 3,352 të paprogramuara. Në nivel kombëtar rezulton që plani vjetor i inspektimeve është realizuar në masën 89,17% sipas planit të miratuar.

Masat administrative në terren për vitin 2025

Për OBU të cilët nuk kanë plotësuar standartet ushqimore të parashikuara në legjislacionin në fuqi janë vendosur përkatësisht:

- 934 paralajmërime;
- 95 gjoba me vlerë 16,910,000 lekë;
- 111 raste bllokimesh me sasi 119,1 ton, 6,815 litra, 1,186,449 kokrra vezë;
- 92 raste asgjësimesh me sasi 911,6 ton dhe 445,709 litra, 918,936 kokrra vezë dhe 832 copë;
- 7 ndërprerje aktivitetesh;
- Kthim në vëndin e origjinës për 18 ngarkesa me sasi 126,9 ton, 1,405 litra, 1,388 copë dhe 20 krerë⁹.

⁸ Pikat e Inspektimit Kufitar.

⁹ Të dhëna zyrtare nga Autoriteti Kompetent për Inspektimin e Ushqimit dhe Ushqimit për Kafshë.

Objektivi i politikës

- *Vendosni objektiva që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij.*
- *Sigurohuni që objektivat janë specifike, të matshëm, të arritshëm, realë dhe në kohë.*

Objektivat kryesore të politikës së këtij projektligji janë siç vijon:

1. Deri në fund të vitit 2028, të reduktohen me 20% rastet e shkeljeve të raportuara për sigurinë ushqimore, përmes standardeve më të forta dhe inspektimeve të rregullta. Forcimi i mjedisit rregullator në funksion të përmirësimit të mbrojtjes së shëndetit të konsumatorëve, shëndetit të kafshëve dhe shëndetit të bimëve brenda vitit 2028 si dhe siguri i të paktën 2 inspektimeve në vit për cdo OBU.
2. Ruajtja dhe trajtimi i kujdesëm i interesave të operatorëve të biznesit në fushën e sigurisë ushqimore monitorimi për këtë qëllim brenda vitit 2028.
3. Krijimi i aksesit të pakufizuar dhe rritjen e aftësive konkurruese për Shqipërinë në tregjet ndërkombëtare të ushqimit deri në vitin 2028, të dyfishohen marrëveshjet e njohjes reciproke dhe certifikatat fitosanitare, duke rritur me 30% volumin e eksporteve ushqimore. Promovimi i prodhimit dhe i cilësisë së qëndrueshme të ushqimit nëpërmjet zhvillimit të një sektori konkurrues dhe inovativ agroushqimor.
4. Forcimi i kapacitetet institucionale dhe administrative drejt harmonizimit të Acquis Communautaire të BE-së në fushën e sigurisë ushqimore, shëndetit të kafshëve dhe të bimëve deri në vitin 2028, do të sigurohet njohje reciproke më e madhe për marrëveshjet dhe certifikatat fitosanitare, duke rritur me 15% volumin e eksporteve ushqimore si dhe trajnimi i stafit administrativ brenda vitit 2028.
5. Përgatitja e kuadrit ligjor përkatës, që rregullon kontrollet zyrtare, në lidhje me sigurinë ushqimore, shëndetin e kafshëve dhe të bimëve në të njëjtën linjë me parashtrimet e kuadrit ligjor të BE-së (*EU acquis*), në kuadrin e një politike kombëtare të konsoliduar.

Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara

- *Përshkruani opsionin e status quo-së.*
- *Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.*
- *Shpjegoni se si janë zgjedhur opsionet e renditura.*

Gjatë analizës së kryer, janë shqyrtuar të tre opsionet:

Opsioni 0 – Ruajtja e status quo-së; Qëndrimi në gjendjen aktuale, duke zbatuar ligjet aktuale në fuqi për kontrollet zyrtare, nënkupton mos dhënien e një zgjidhjeje problematikave të evidentuara, mos adresimin e tyre me kahje nga BE si dhe mos plotësimin e detyrimeve për përafrimin ligjor me aquis e BE-së.

Opsioni 1 - (rregullator): Miratimi i një ligji të ri i cili unifikon kuadrin ligjor dhe përcakton rregullat për kontrollet zyrtare në fushën e sigurisë ushqimore, ushqimin dhe ushqimin për kafshë dhe mbrojtjen e bimëve duke dhënë jep zgjedhjen e duhur problematikave të evidentuara dhe duke ecur në drejtim të forcimit të tregut të brendshëm dhe atij europian si rezultat i përmbushjes së standarteve europian në këto fusha. Ky është opsioni i zgjedhur nga ne si më i përshtatshëm, i cili trajton dhe zgjidh një sërë çështjesh problematike në kohë, dhe që jep rezultatet e duhura në raport me objektivat që Qeveria synon të përmbushë. Harmonizimi me aquis e BE-së bëhet me qëllim të krijimit të një qasje të integruar dhe uniforme ndaj kontrolleve zyrtare përgjatë zinxhirit agro-ushqimor. Nisma synon të

përafrojnë Rregulloren 2017/625 e cila është në mënyrë specifike plotësim i një kushti më shumë për arritjen e standarteve të BE-së, vendosjen në kushte të barabarta të tregëtuesit shqiptar në raport me atë evropian, lehtësimin e buxhetit të shtetit dhe vendosjen e tarifave për OBU-të për ushtrimin e kontrolleve, unifikimin e legjislacionit dhe përfshirjen në një kuadër të vetëm ligjor të të gjitha kontrolleve zyrtare që ushtrohen në kuadër të ushqimit, ushqimit për kafshë dhe shëndetit të bimëve. Gjithashtu vlen të theksojmë se rregullat e teknikës legjislative diktojnë se në lidhje me përafrimin e pjesshëm të rregulloreve të BE-së, kur këto të fundit impaktojnë me ndryshime thelbësore rendin juridik apo thënë ndryshe sjellin një ripërcaktim të fushës që rregullojnë, nuk parashikojnë sjelljen e këtyre ndryshimeve në kuadrin egzistues legjislativ por medoemos kërkohet miratimi i një ligji të ri sic është edhe rasti ynë konkret.

Opsioni 2 - (rregullator): Rishikimi i ndryshimeve ligjore në legjislacionin aktual nuk adreson problematikat e evidentuara duke mos patur një kuadër ligjor solid dhe të unifikuar e duke mos marrë si pasojë rezultatet e pritshme në aspektin e përafrimit të legjislacionit me *acquis* por edhe duke mos dhënë zgjidhje problematikave si pasojë e fragmentizimit ligjor, identifikimin jo të plotë dhe mbivendosjen e kompetencave mes organeve zbatuese legjislative.

Opsioni 3 – (jorregullator): Ky opsion do të ishte forcimi i zbatimit të ligjit egzistues në fuqi nga strukturat kompetente. Trajnimi i stafit, forcimi i kërkesës së llogarisë, analizimi i terrenit më i shpeshtë etj. Qeveria mund të fokusohet në forcimin e zbatimit të rregulloreve dhe legjislacionit ekzistues, trajnimeve dhe mbikëqyrjes më të fortë të institucioneve dhe operatorëve të biznesit në këta sektorë. Ky opsion nuk ofron zgjidhjen e duhur për problematikat e evidentuara dhe as përmbushjen e qëllimeve që ka vënë Qeveria Shqiptare për arritjen e kushteve të anëtarësimit në BE.

Opsioni 0 – Ruajtja e status quo-së

Avantazhet:

- Nuk kërkon ndryshime të menjëhershme ligjore apo investime shtesë në infrastrukturë.
- Vazhdon funksionimin e mekanizmave aktualë pa ndërprerje.

Disavantazhet:

- Nuk adresohen problemet dhe sfidat e identifikuara në sistemin aktual të kontrolleve zyrtare.
- Mosplotësimi i detyrimeve për harmonizimin me *acquis-in* e Bashkimit Evropian pengon avancimin në procesin e integritetit evropian.
- Rrezikon përkeqësimin e situatës në fushën e sigurisë ushqimore dhe mbrojtjes së shëndetit të kafshëve dhe bimëve për shkak të mungesës së reformave.
- Kufizon zhvillimin e tregut të brendshëm dhe mund të ndikojë negativisht në besueshmërinë ndërkombëtare të produkteve shqiptare.

Opsioni 1 – Miratimi i ligjit të ri (Opsioni i zgjedhur)

Avantazhet:

- Ofron një kuadër ligjor të unifikuar dhe të harmonizuar me *acquis-in* e BE-së, duke avancuar në procesin e integritetit evropian.
- Zgjidh në mënyrë sistematike problemet e identifikuara dhe adreson fragmentimin dhe mbivendosjet e kompetencave.
- Forcon tregun e brendshëm dhe promovon konkurrencën e drejtë në sektorët agro-ushqimorë.
- Përmirëson besueshmërinë dhe sigurinë e produkteve ushqimore dhe atyre për kafshë dhe shëndetin e bimëve, duke mbrojtur shëndetin publik dhe mjedisin.

- Përkrah qëndrueshmërinë institucionale përmes përcaktimit të qartë të rregullave, organizimit dhe financimit të kontrolleve zyrtare.

Disavantazhet:

- Mund të kërkojë kohë dhe burime për zbatimin e plotë të reformës ligjore dhe përshtatjen e institucioneve.
- Implementimi i suksesshëm varet nga gatishmëria institucionale dhe angazhimi i vazhdueshëm.

Opsioni 2 – Rishikim i ndryshimeve ligjore në ligjislacionin aktual

Avantazhet:

- Mund të jetë më i lehtë dhe më i shpejtë për t'u zbatuar sesa një ligj i ri.
- Mund të përmirësojë disa aspekte të ligjit ekzistues pa nevojën për një reformë të plotë.
- Paraqet me pak kosto.

Disavantazhet:

- Nuk krijon një kuadër ligjor të unifikuar dhe të qartë, duke lënë hapësirë për fragmentim dhe mbivendosje kompetencash.
- Nuk adreson në mënyrë efektive problemet thelbësore të kontrollit zyrtar dhe harmonizimit me *acquis-in* e BE-së.
- Rrezikon të mos arrijë rezultatet e dëshiruara në përmirësimin e sigurisë ushqimore dhe mbrojtjes së bimëve dhe kafshëve.
- Mungesa e një qasjeje gjithëpërfshirëse mund të çojë në mbivendosje të përgjegjësisë dhe mungesë koordinimi mes institucioneve.

Opsioni 3 – Forcimi i zbatimit të ligjit ekzistues (Opsion jorregullator)

Avantazhet:

- Mund të realizohet shpejt përmes trajnimeve, forcimit të inspektimeve dhe monitorimit më të mirë.
- Përmirëson funksionimin praktik të institucioneve pa nevojën për ndryshime ligjore.
- Rrit përgjegjësinë e aktorëve në terren dhe mund të ulë praktikën e paligjshme përmes kontrolleve më rigorozë.

Disavantazhet:

- Nuk zgjidh problemet strukturore dhe ligjore që pengojnë efektivitetin e përgjithshëm të sistemit.
- Nuk përmbush detyrimet ligjore për përafrimin me *acquis-in* e BE-së dhe integrimin evropian.
- Pa reforma ligjore, fuqia e kontrollit mbetet e kufizuar dhe mund të jetë e pamjaftueshme për të adresuar sfidat afatgjata.
- Rrezikon që rezultatet e përmirësuar në zbatim të jenë të përkohshme dhe jo të qëndrueshme në mungesë të kuadrit ligjor të duhur.
- Trajnimet e vazhdueshme dhe kontrollet e shpeshta kërkojnë burime financiare dhe njerëzore, por nuk sigurojnë efektivitet të plotë në mungesë të bazës ligjore të përmirësuar.
-

Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve

- *Identifikoni se kush preket.*
- *Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur; bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.*
- *Për ndikimet e drejtpërdrejta:*
- *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
- *Analizoni nga ana sasiore ndikimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta.*

- *Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta aty ku është e mundur (shih aneksin 1/a për tabelën që mund të përdorni)*

Grupet që preken janë:

- o *Qeveria;*
- o *Operatorët e bizneseve;*
- o *Fermerët;*
- o *Shoqëria civile;*
- o *Punëmarrësit.*

o *Qeveria* –rrit punësimin, plotëson kushtet lidhur për afrimin e legjislacionit, forcon marrëdhëniet ndërkombëtare dhe rajonale për zbatimin e PPB, ofron informacion statistikor në bujqësi të saktë, real dhe efikas, rritet besimi te përdoruesit etj.

o *Operatorët e bizneseve* –preken nga ky ligj pasi ligji parasheh normim të ri, vihen në dijeni për të gjitha të dhënat lidhur me aktivitet etj.

o *Fermerët*- do të aplikojnë metoda të reja të raportimit të informacionit, rritje e fuqisë konkurruese në tregun e brendshëm, mundësinë e eksportit apo rritjen e eksportit, , përmirësimin e kushteve të zhvillimit të veprimtarisë bujqësore për ta etj.

o *Shoqëria civile*- intensifikimi, zgjerimi dhe modernizimi i bujqësisë përforcon ofertën ekonomike dhe sociale në ato zona, duke sjellë një jetesë më të mirë për banorët ruralë, duke u ofruar të rinjve një mundësi më tepër punësimi dhe një ofertë ekonomike tërheqëse, dhe kështu edhe produkte më të mira dhe siguri më të lartë ushqimore etj.

o *Punëmarrësit* - më shumë mundësi punësimi si pasojë e hapjes së tregëtisë e eksportit, me shumë mundësi punësimi për profesionistët në fushën e bujqësisë etj.

Disa nga grupet e prekura kanë përfitime të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta , të ndara në pozitive dhe negative, siç vijon:

1. Qeveria

Ndikime të drejtpërdrejta

Pozitive:

- ❖ Siguron cilësinë e ushqimit duke ulur përdorimin e pesticideve me **10–15%** brenda 3 viteve.
- ❖ Përbush objektivat strategjike për përafrim me standardet e BE-së.
- ❖ Përforcon kuadrin ligjor dhe institucional mbi sigurinë ushqimore, shëndetin dhe mirëqënien e kafshëve dhe mbrojtjen e bimëve.
- ❖ Përmirëson sistemin e kontrollit zyrtar dhe harmonizimin e legjislacionit.
- ❖ Siguron bazë të dhënash bujqësore të standardizuar dhe më efikase.
- ❖ Rrit transparencën dhe besueshmërinë e institucioneve publike.
- ❖ Rritje të të ardhurave të buxhetit të shtetit, +4.6 mln lekë në vit (hipotetike rritje 5% e të ardhurave të gjeneruara nga institucionet gjatë vitit 2024).

Negative:

- Kosto administrative fillestare për zbatimin e sistemit të ri të kontrollit dhe trajnimit e stafit.

- Rritje e ngarkesës institucionale në fazën e tranzicionit.

Ndikime jo të drejtpërdrejta

Pozitive:

- ❖ Përmirësim i imazhit ndërkombëtar të vendit dhe marrëdhënieve me partnerët europianë.
- ❖ Rritje e investimeve të huaja dhe bashkëpunimit ndërkombëtar.
- ❖ Zvogëlim i korrupsionit dhe forcim i bashkëpunimit ndërinstytucional.
- ❖ Përmirësim i pozicionit të vendit në negociatat e anëtarësimit në BE.
- ❖ Ul rastet e shkeljeve të konstatuara në terren me rreth 10% brenda 2 vitesh.

Negative:

- ❖ Varësi më e lartë nga mbështetja e partnerëve ndërkombëtarë në zbatimin fillestar të reformës.

2. Fermerët

Ndikime të drejtpërdrejta

Pozitive:

- ❖ Rritje e të ardhurave përmes aksesit në tregje të reja dhe subvencione.
- ❖ Përmirësim i kushteve të punës dhe efikasitetit në fermë.
- ❖ Mundësi për certifikim dhe eksport të produkteve në BE.
- ❖ Rritja e përputhshmërisë së fermerëve me standardet me rreth 15% brenda 4 vitesh.
- ❖ Ulja e përdorimit të pesticideve me rreth 10-15%.
- ❖ Rritje e mbështetjes teknike për kontrollin e bimëve.
- ❖ Rritje e cilësisë së prodhimit

Negative:

Rritje e kostove fillestare për përshtatje me standardet e reja (investime në pajisje, trajnime) Kërkesa më e madhe për dokumentacion dhe raportim administrativ. Ndikime jo të drejtpërdrejta

Pozitive:

- ❖ Rritje e njohurive profesionale dhe menaxhimit bujqësor.
- ❖ Stabilitet ekonomik në zonat rurale dhe ulje e emigrimit.
- ❖ Rritje e reputacionit të produkteve vendase në treg.
- ❖ Ulja e rrezikut shëndetësor nga ekspozimi ndaj pesticideve.

Negative:

- ❖ Fermerëve të vegjël që nuk kanë kapacitet të përshtaten me kërkesat e reja mund të mos përfshihen në përfitimin e të mirave.

3. Operatorët e bizneseve (agrobizneset, tregtarët, eksportuesit)

Ndikime të drejtpërdrejta

Pozitive:

- Rritje e cilësisë së produkteve dhe akses në tregjet e BE-së.

- Mundësi bashkëpunimi me biznese të huaja dhe partnerë strategjikë.
- Rritje me 30% e eksporteve deri në vitin 2030.
- Rritje e përputhshmërisë me standardet me rreth 15%

Negative:

- Kostot fillestare të përshtatjes me ligjin (certifikime, pajisje, dokumentacion).
- Shtim i detyrimeve ligjore dhe burokracisë.
- Reduktim i përdorimit të pesticideve me rreth 10-15%

Ndikime jo të drejtpërdrejta

Pozitive:

- Rritje e konkurrencës që nxit inovacionin dhe eficiencën.
- Zhvillim i zinxhirit të vlerës (prodhim–përpunim–eksport).
- Përmirësim i imazhit të produkteve shqiptare jashtë vendit.
- Rritje e reputacionit të produkteve në treg

Negative:

- Mundësi e shtimit të presionit ekonomik mbi bizneset e vogla për shkak të standardeve të reja.

4. Punëmarrësit

Ndikime të drejtpërdrejta

Pozitive:

- Krijim i vendeve të reja të punës në zonat rurale dhe përmirësim i kushteve të punës.
- Mundësi trajnimi dhe zhvillimi profesional.
- Ulja e ekspozimit të punonjësve ndaj pesticideve me 10–12%.
- Përmirësim i kushteve të punës.

Negative:

- Rritje e pasigurisë në tregun e punës gjatë fazës kalimtare të zbatimit të ligjit (ndryshime në kërkesat profesionale).
- Nevojë për trajnim shtesë dhe certifikime.

Ndikime jo të drejtpërdrejta

Pozitive:

- Rritje e stabilitetit ekonomik familjar dhe ulje e papunësisë rurale.
- Kthim i të rinjve drejt zonave rurale.
- Përmirësim i sigurisë ushqimore për konsumatorët.

Negative:

- Kërkesa më e madhe për kualifikim mund të përjashtojë punëtorët me aftësi të ulëta në fazën fillestare.

5. Shoqëria civile / komuniteti

Ndikime të drejtpërdrejta

Pozitive:

- Përmirësim i cilësisë së jetesës dhe i produkteve ushqimore.
- Promovim i zhvillimit të qëndrueshëm dhe përfshirjes sociale.
- Mundësi më të mëdha për punësim në zonat rurale.

Rritje e transparencës të të dhënave të sigurisë ushqimore:

Negativ:

- Rritje e pabarazive nëse përfitimet nuk shpërndahen njëtrajtësisht në zonat rurale.

Ndikime jo të drejtpërdrejta

Pozitive:

- Ulje e varfërisë dhe rritje e barazisë sociale.
- Pjesëmarrje më e madhe e shoqërisë civile në transparencë dhe monitorim.
- Përmirësim i shëndetit publik përmes produkteve më cilësore.

Negative:

- Rrezik i rritjes së varësisë nga subvencionet shtetërore për disa grupe komunitare.

Ndikimet Kryesore të Projektligjit:

1. Sociale:

- Nxiti rritjen e standarteve të jetesës përmes punësimit dhe zhvillimit rural.
- Përfitime për komunitetet rurale nga zhvillimi ekonomik dhe social.
- Përmbushje e kushteve për anëtarësimin në BE synim arritja e të cilit impakton në mënyrë thelbësore, pozitive shoqërinë shqiptare e cila bëhet pjesë e komunitetit europian me të drejta dhe detyrime të plota si shtet anëtar.

2. Ekonomike:

- Zhvillimet e bizneseve kanë efekte pozitive në rritjen e eksportit dhe tregtisë duke forcuar ekonominë kombëtare.
- Forcim dhe mirëfunksionim i tregut të brendshëm dhe rritje e aftësive konkurruese në tregun europian.
- Krijimi i aksesit të pakufizuar në tregun europian dhe më gjërë pritet të ketë impakt shumë pozitiv në ekonominë e vëndit, rritja e eksportit dhe tregtisë gjithashtu forcon ekonominë kombëtare.
- Përfitime nga investitorë të huaj dhe grantë nga BE;
- Investimet në standarde dhe teknologji krijojnë kosto fillestare, por përkthehen në përfitime afatgjata për të gjitha palët.

3. Mjedisore:

- Zhvillimi i sektorit bujqësisë në zonat rurale pritet të ketë ndikim pozitiv në ruajtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm të aktiviteteve bujqësore,
- Ligji i ri do të ketë një ndikim pozitiv të drejtpërdrejtë në mjedis nëpërmjet kontrollit dhe gjurmueshmërisë më të mirë të bimëve dhe duke reduktuar rrezikun e dëmeve të mëdha mjedisore që vijnë si rrjedhojë e përhapjes së dëmtuesve në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- Më pak produkte për mbrojtjen e bimëve si rezultat i bimëve më të më të shëndetshme duke ulur njëkohësisht nivelin e ndikimit në mjedis të mbetjeve që vijnë nga PMB-të ose ambalazhimi i tyre.
- Modernizimi i sektorit të bujqësisë impakton rritjen e standarteve ekonomike të njësive ekonomike të cilat ndërmarrin veprimtari ekonomike në bujqësi ose

mirëmbajnë tokën bujqësore në gjendje të mirë bujqësore dhe mjedisore brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

Këto ndikime sociale, ekonomike dhe mjedisore janë të përgjithshme dhe përfshijnë të gjithë aktorët kryesorë të shoqërisë, pasi burojnë nga miratimi dhe zbatimi në nivel kombëtar i projektligjit. Megjithatë, disa grupe preken më drejtpërdrejt se të tjerët:

Ndikime sociale, ekonomike dhe mjedisore janë të përgjithshme dhe shtrihen në nivel kombëtar, pasi miratimi i ligjit prek të gjithë sektorin bujqësor dhe shoqërinë në tërësi. Ligji sjell përfitime që reflektohen në përmirësimin e jetesës në zonat rurale, forcimin e ekonomisë kombëtare përmes rritjes së tregtisë dhe eksportit, si dhe në mbrojtjen e mjedisit përmes zhvillimit të qëndrueshëm të bujqësisë. Në këtë mënyrë, ai kontribuon drejtpërdrejt në modernizimin e vendit dhe në përafrimin me standardet e Bashkimit Europian.

Nga analiza e mësipërme duke vlerësuar kostot por edhe përfitimet dalim në përfundimin se të gjitha kostot dhe investimet që do të kryhen në këtë fushë janë kosto të cilat në plane afatgjata përktihen në përfitime për aktorët e zinxhirit ushqimor dhe për shoqërinë në tërësi si dhe në një linjë me politikat e Qeverisë për plotësimin e kushteve për anëtarësimin në BE.

Kosto të drejtpërdrejta në sektorin publik: Momentalisht identifikohen kosto në sektorin publik pasi kompetencat do të ushtrohen nga të njëjtat institucione dhe staf administrativ.

Kosto të drejtpërdrejta në sektorin privat:

1. Kosto administrative dhe e përputhshmërisë me legjislacionin

- **Shkaku:**

Bizneset duhet të harmonizojnë praktikën e tyre me standardet e kontrollit zyrtar: dokumentacion më i detajuar, gjurmueshmëri, etiketime, sisteme IT, raportim.

- **Pasoja për biznesin:**

- Investim fillestar në sisteme menaxhimi të cilësisë (HACCP, ISO, etj.)
- Trajnim i stafit për procedura të reja
- Pagesë për auditime të brendshme dhe të jashtme
- Kosto e raportimit të vazhdueshëm dhe ruajtjes së të dhënave

- **Përfitime:**

- Rrit sigurinë ligjore dhe shmang ndëshkimet në kuadër të ligjit;
- Rrit besimin te konsumatori dhe partnerët tregëtarë;
- Lehtëson eksportin në tregjet e BE-së dhe jashtë saj;
- Përmirëson imazhin e markës dhe qëndrueshmërinë në treg.

2. Tarifat e detyrueshme për kontrollet zyrtare

- **Shkaku:**

Sipas rregullores, për aktivitete të caktuara (mish, peshk, qumësht, kufij), bizneset duhet të paguajnë tarifa për kontrolle.

- **Pasoja për biznesin:**

- Rritje e shpenzimeve operative, veçanërisht për bizneset e vogla;
- Barrë e rënduar për mikro-ndërmarrjet që kanë marzhe të vogla fitimi;
- Mungesë e harmonizimit të tarifave me shtetet e BE-së krijon konkurrencë të pabarabartë.

- **Përfitime:**

- Tarifat sigurojnë që kontrollet të kryen në kohë dhe me cilësi;
- Ndihmojnë në krijimin e një gare të ndershme tregtare, nëse harmonizohen;
- Bizneset me standardet përfitojnë nga besimi dhe qasja më e lehtë në tregje ndërkombëtare.

- Rritje e të ardhurave të buxhetit të shtetit me +4.5 mln lekë në vit (hipotetike rritje 5% e të ardhurave të gjeneruara nga institucionet gjatë vitit 2024).

Theksohet se kjo analizë është hipotetike.

Projektligji për kontrollet zyrtare vlerësohet të ketë një **ndikim pozitiv dhe të qëndrueshëm në financat publike**, pa krijuar barrë të konsiderueshme financiare për bizneset.

Vlerësimi bazohet në të ardhurat e realizuara në vitin 2024 nga institucionet vartëse të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (AKVMB, AKU dhe ISUV), të cilat kanë gjeneruar **90.3 milion lekë** për buxhetin e shtetit. Vendosja e tarifave minimale për kontrollet zyrtare pritet të sjellë një **rritje të moderuar prej rreth 5% të të ardhurave vjetore** (afërsisht **+4.5 milion lekë**) në tota **94.8 milion lekë**, e cila do të reflektohet dy vite pas miratimit të ligjit.

Analiza financiare përfshin vetëm komponentin e **tarifave të detyrueshme për kontrollet zyrtare**, si i vetmi element me disa të dhëna të verifikueshme. Kostot e tjera potenciale për bizneset nuk janë përfshirë, për shkak të mungesës së të dhënave të nevojshme për një vlerësim të saktë financiar, si dhe varjojnë në bazë të kapaciteteve të secilit biznes.

Projektligji **nuk parashikon kosto shtesë për buxhetin e shtetit**, pasi zbatimi i tij mbështetet në strukturat ekzistuese administrative, laboratorike dhe njerëzore. Ndërkohë, ndikimi mbi bizneset vlerësohet **i kufizuar dhe i përballueshëm**, duke qenë se tarifat e propozuara janë minimale dhe më të ulëta se kostoja reale që aktualisht mbulon buxheti publik për kryerjen e kontrolleve.

Në tërësi, ndërhyrja forcon qëndrueshmërinë financiare të sistemit të kontrolleve zyrtare, përmirëson eficiencën dhe transparencën institucionale dhe kontribuon në përafrimin me standardet dhe legjislacionin e Bashkimit Evropian në fushën e sigurisë ushqimore dhe mbrojtjes së shëndetit publik.

3. Kosto për investime teknike dhe infrastrukturore

- **Shkaku:**
Për të përmbushur kërkesat e sigurisë ushqimore dhe të kontrollit, bizneset duhet të investojnë në pajisje, laboratorë të brendshëm, hapësira magazinimi, etiketime inteligjente, etj.
- **Pasoja për biznesin:**
 - Kosto të konsiderueshme kapitale, veçanërisht për bizneset e vogla;
 - Vështirësi për të siguruar financim apo kredi për përmirësime teknologjike;
 - Vonesë në rikuperimin e investimeve për shkak të fitimeve të ulëta;
- **Përfitime:**
 - Rrit eficientësi operationale dhe ul konstat në plan afatgjatë;
 - Lejon prodhim më të qëndrueshëm dhe me më pak mbetje;
 - Rrit besueshmërinë në auditime dhe kontrolle të jashtme;
 - Mbron produktin ndaj dështimeve ose sekuestrimeve eventuale nga tregu.

4. Kosto për përputhje të vazhdueshme

- **Shkaku:**
Përveç tarifave, bizneset përballen me kosto të vazhdueshme për të ruajtur standartin si: auditime të rregullta, trajnime të vazhdueshme, dokumentacion, kontroll vetjak (vetkontrollin).
- **Pasoja për biznesin:**
 - Kosto mujore për mbajtje dosjesh, certifikime të përtëritura, shërbime laboratorike;
 - Shtim i kohës jo-për qëllime fitimrurëse për menaxherët dhe stafin teknik;
 - Ndikim i madh në koston e produktit për mikrondërmarrjet.
- **Përfitime:**
 - Redukton rrezikun e ndështimit administrativ, pezullimeve dhe bllokimeve nga autoritetet;
 - Ndihmon në rast inspektimesh të paparalajmëruara në treg;
 - Shërben si avantazh konkurrues në tendera dhe bashkëpunime me rrjete të mëdha shitjeje.

5. Ndikim indirekt në çmimet e tregut dhe konkurrencën

- **Shkaku:**
Mungesa e harmonizimit të tarifave dhe standardeve mes vendeve të BE-së sjell kushte të pabarabarta konkurruese.
- **Pasoja për biznesin:**
 - Bizneset që operojnë në vende me tarifa më të larta ndihen të penalizuar;
 - Operatorët që zbatojnë ligjin mund të humbasin treg ndaj atyre që “anashkalojnë” rregullat;
 - Presion për të ulur cilësinë për të ruajtur çmimet konkurruese.
- **Përfitime**
 - Harmonizimi mund të krijojë treg më të drejtë dhe konkurrencë të barabartë;
 - Bizneset që investojnë në cilësi mund të përfitojnë më shumë treg nëse zbatimi është universal;
 - Rregullimi i drejtë i tarifave mund të nxisë inovacion dhe efikasitet.

Zbatimi i Rregullores (BE) 2017/625 sjell një sërë ndikimesh konkrete mbi sektorin privat, veçanërisht mbi operatorët në zinxhirin agro-ushqimor, me theks të veçantë mbi mikrondërmarrjet dhe ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Këto ndikime shfaqen në formën e kostove administrative, tarifave të detyrueshme, investimeve teknike dhe barrës së përhershme për ruajtjen e përputhshmërisë.

Megjithatë, pavarësisht sfidave financiare që lidhen me përshtatjen ndaj sistemit të përforcuar të kontrollit zyrtar, kjo rregullore ofron një gamë të gjerë përfitimesh strategjike për operatorët privatë. Nëpërmjet përmbushjes së standardeve të kërkuara, bizneset fitojnë jo vetëm akses më të lehtë në tregje të BE-së dhe ato ndërkombëtare, por gjithashtu rrisin besimin e konsumatorëve dhe partnerëve, forcojnë reputacionin e tyre dhe ndërtojnë një avantazh të qëndrueshëm konkurrues.

Kostot e paraqitura – nga tarifat, tek investimet në infrastrukturë dhe trajnime – janë të konsiderueshme, por në shumë raste ato përbëjnë një investim afatgjatë, që ul rrezikun e ndëshkimeve në kuadër të ligjit, humbjeve ekonomike nga incidentet e sigurisë ushqimore dhe garanton vazhdimësinë e operacioneve në një treg gjithnjë e më të rregulluar dhe të ndjeshëm ndaj cilësisë.

Në fund, suksesi në përballimin e këtyre sfidave varet nga balancimi i drejtë midis kostove të zbatimit dhe **përfitimeve reale që sjell përputhshmëria me rregulloren**, duke pasur gjithmonë në fokus mbrojtjen e konsumatorit, sigurinë ushqimore dhe qëndrueshmërinë e bizneseve të përgjegjshme.

Ndikimet e drejtpërdrejta sociale

Kontrolli zyrtar mbi sigurinë ushqimore mund të ndikojë drejtpërdrejt në sigurinë e konsumatorëve duke ulur rrezikun e sëmundjeve dhe helmimeve nga ushqimi. Gjithashtu, këto kontrolle mund të krijojnë vende pune të reja në sektorin e inspektimeve dhe certifikimeve, duke ndikuar pozitivisht në punësim dhe mirëqenie ekonomike lokale.

Ndikimet jo të drejtpërdrejta sociale

Përmirësimi i sigurisë ushqimore mund të ndikojë në mënyrë jo të drejtpërdrejtë në rritjen e besimit të konsumatorëve në produkte lokale, duke nxitur zhvillimin ekonomik afatgjatë të komuniteteve rurale dhe fermerëve të vegjël. Gjithashtu, përmirësimet në kushtet e punës në sektorin agro-ushqimor, si pasojë e kontrolleve më strikte, mund të përmirësojnë shëndetin dhe sigurinë e punonjësve në mënyrë indirekte.

Ndikimet e drejtpërdrejta mjedisore

Në kontekstin e kontrolleve zyrtare, një ndikim i drejtpërdrejtë mjedisor mund të jetë reduktimi i përdorimit të pesticideve apo substancave të dëmshme, për shkak të verifikimeve më të rrepta në prodhimin ushqimor, që ndihmon në mbrojtjen e tokës, ujit dhe biodiversitetit lokal. Gjithashtu, kontrollet mund të detyrojnë bizneset të përmirësojnë menaxhimin e mbetjeve dhe të ndotjes, duke zvogëluar ndotjen mjedisore në vend.

Ndikimet jo të drejtpërdrejta mjedisore

Politika e kontrolleve mund të nxisë një zhvillim më të qëndrueshëm në zinxhirin ushqimor, duke promovuar përdorimin e praktikave miqësore me mjedisin dhe teknologjive të pastra. Në këtë mënyrë, ndikon në reduktimin afatgjatë të emetimeve të gazrave serrë dhe degradimit të ekosistemeve. Përfitimet e tilla ndikojnë në përmirësimin e cilësisë së jetës dhe ruajtjen e burimeve natyrore për brezat e ardhshëm.

Arsyetimi i opsionit të preferuar

- Zgjidhni opsionin e preferuar, bazuar në analizë.
- Shpjegoni arsyetimintuaj.

Opsioni 1 - (rregullator):

Projektligji për Kontrollin Zyrtar – Perspektiva e Re- Në kuadër të përmirësimit të mëtejshëm të mekanizmave mbikëqyrës, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka propozuar miratimin e projektligjit të ri për “Për kontrollet zyrtare dhe veprimtari të tjera zyrtare të kryera për të garantuar zbatimin e legjislacionit mbi ushqimin dhe ushqimin për kafshë, rregullimeve mbi shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve si dhe mbi shëndetin e bimëve dhe produkteve për mbrojtjen e bimëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky projektligj synon të forcojë standardet e kontrollit, duke vendosur rregulla të qarta dhe procedura strikte që do të garantojnë një nivel më të lartë mbrojtjeje të shëndetit të njerëzve, kafshëve dhe bimëve në të gjithë zinxhirin ushqimor. Një element kyç i projektligjit është kryerja e

kontrolleve pa njoftim paraprak, përveç rasteve të jashtëzakonshme ku një njoftim i tillë është i domosdoshëm dhe i justifikuar.

Opsioni 1 mundëson zbatimin e plotë të qasjes kontroll me bazë risku në sektorë ku autoritetet kompetente aktualisht nuk e realizojnë këtë si p.sh. kontrollet zyrtare të kryera në kufijtë e BE-së mbi mallra të caktuara nga vendet e treta dhe kontrollet zyrtare mbi mbetjet e barnave veterinarë. Kjo do të rezultojë në organizim më efikas të programeve të kontrollit. Për më tepër, mundësimi i autoriteteve kombëtare për të përqendruar fokusin e tyre aty ku risku paraqitet më i lartë minimizon barrën e kontrolleve zyrtare mbi ato biznese të cilat përmbushin kushtet ligjore e për rezultat rritje e aftësive të tyre konkurrese në treg.

Nisma ligjore që propozojmë identifikon një numër aktiviteteve kontrolli (kryesisht mbi mishin, qumështin, prodhimin e peshkimit dhe mbi kontrollet e kryera që kryehen në kufinj) për të cilat autoritetet kompetente do të mbledhin një tarifë nga operatorët (tarifë e detyrueshme) për të rikuperuar kostot e kontrollit. Rregullorja 2017/625 ka lënë të hapur mundësinë e zgjedhjes për aktivitete të tjera kontrolli, për të cilat shtete do të vendosin në mënyrë të pavarur nëse do të ngarkojë një tarifë mbi operatorët apo jo.

Opsioni 1 do të krijonte barazi për të gjithë operatorët e ngarkuar me tarifa të detyrueshme. Dispozitat e reja do të sigurojnë që mekanizmi i financimit të kontrolleve mund të përdoret nga SHM për të shpërblyer bizneset me performancë të mirë dhe me risk të ulët, edhe kur tarifat me normë fikse zbatohen për të gjithë operatorët, pavarësisht nëse ata inspektohen në të vërtetë gjatë periudhës referuese (duke i ngarkuar ata me një tarifë më të ulët se ajo e aplikuar për operatorët që nuk përputhen). Kostot shtesë pritet të jenë të përballueshme nga buxhetet publike.

Opsioni 1 parashikohet të rrisë llogaridhënien e aktiviteteve të kontrollit duke krijuar një transparencë të plotë lodhur me kostot dhe tarifat duke përdorur mekanizma ligjorë përmes së cilëve operatorët do të jenë në dijeni të plotë mbi kostot dhe tarifat të cilat priten të paguhet prej tyre.

Gjatë punës për draftimin e Raportit të Vlerësimit të Ndikimit janë marrë në konsideratë edhe dokumentet shoqëruese të Rregulloren Evropiane (BE) 2017/625 “Mbi kontrollet zyrtare dhe aktivitete të tjera zyrtare të kryera për të siguruar zbatimin e ligjit për ushqimin dhe ushqimin për kafshët, rregullat për shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve, shëndetin e bimëve dhe produktet për mbrojtjen e bimëve” e cila do të përafrohet pjesërisht me miratimin e propozimit të nismës që sjell Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, “Për kontrollet zyrtare dhe veprimtari të tjera zyrtare të kryera për të garantuar zbatimin e legjislationit mbi ushqimin dhe ushqimin për kafshë, rregullimeve mbi shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve si dhe mbi shëndetin e bimëve dhe produkteve për mbrojtjen e bimëve në Republikën e Shqipërisë”. Në mënyrë të veçantë përmendim këtu Impact Assessment i cili është dokumenti shoqërues i rregullores së sipërcituar dhe i cili është përdorur si referencë gjatë draftimit të këtij dokumenti, duke e sjellë atë në frymën e përshtatshme për mjedisin ligjor shqiptar, në përputhje me rregullat e përafrimit të *acquis communautaire* e duke bërë kështu që konkluzionet tona të jenë në përputhje me konkluzionet e këtij dokumenti.

Siç e kemi shpjeguar edhe më lart janë identifikuar katër opsione, si më poshtë vijojnë:

Opsioni 0 – Ruajtja e status quo-së; Qëndrimi në gjendjen aktuale, duke zbatuar ligjet aktuale në fuqi për kontrollet zyrtare, nënkupton mos dhënien e një zgjidhjeje problematikave të evidentuara, mos adresimin e tyre me kahje nga BE si dhe mos plotësimin e detyrimeve për përafrimin ligjor me *aquis* e BE-së.

Opsioni 1 - (rregullator): Miratimi i një ligji të ri i cili unifikon kuadrin ligjor i cili përcakton rregullat për kontrollet zyrtare në fushën e sigurisë ushqimore, ushqimin dhe ushqimin për kafshë dhe mbrojtjen e bimëve duke dhënë jep zgjedhjen e duhur problematikave të evidentuara dhe duke ecur në drejtim të forcimit të tregut të brendshëm dhe atij europian si rezultat i përmbushjes së standarteve europian në këto fusha. Ky është opsioni i zgjedhur nga ne si më i përshtatshëm, i cili trajton dhe zgjidh një sërë çështjesh problematike në kohë, dhe që jep rezultatet e duhura në raport objektivat që Qeveria synon të përmbushë. Harmonizimi me *acquisin* e BE-së bëhet me qëllim të krijimit të një qasje të integruar dhe uniforme ndaj kontrolleve zyrtare përgjatë zinxhirit agro-ushqimor. Nisma ligjore që propozojmë ofron një kuadër të përgjithshëm, të unifikuar për kontrollet zyrtare në sektorët e ushqimit dhe ushqimit për kafshë, duke përcaktuar dispozita të qarta për rregullimin, organizimin dhe financimin e kontrolleve zyrtare.

Opsioni 2 - (rregullator): Rishikimi i ndryshimeve ligjore në ligjislacionin aktual nuk adreson problematikat e evidentuara duke mos patur një kuadër ligjor solid dhe të unifikuar e duke mos marrë si pasojë rezultatet e pritshme në aspektin e përafrimit të ligjislacionit me *acquis* por edhe duke mos dhënë zgjidhje problematikave si pasojë e fragmentizimit ligjor, identifikimin jo të plotë dhe mbivendosjen e kompetencave mes organeve zbatuese legjislative.

Opsioni 3 – (jorregullator): Ky opsion do të ishte forcimi i zbatimit të ligjit egzistues në fuqi nga strukturat kompetente. Trajnimi i stafit, forcimi i kërkesës së llogarisë, analizimi i terrenit më i shpeshtë etj. Qeveria mund të fokusohet në forcimin e zbatimit të rregulloreve dhe ligjislacionit ekzistues, trajnimeve dhe mbikëqyrjes më të fortë të institucioneve dhe operatorëve të biznesit në këta sektorë. Ky opsion nuk ofron zgjidhjen e duhur për problematikat e evidentuara dhe as përmbushjen e qëllimeve që ka vënë Qeveria Shqiptare për arritjen e kushteve të anëtarësimit në BE.

Vendosja e peshës së kriterëve sipas rëndësisë relative.

Për të vlerësuar opsionet duke përdorur analizën me shumë kriterë, janë ndjekur hapat e mëposhtëm:

Janë përcaktuar kriteret që tregojnë arritjen e objektivave dhe është vendosur pesha e kriterëve sipas rëndësisë relative:

1. Efektiviteti në ruajtjen dhe trajtimin e kujdeshëm të interesave të operatorëve të biznesit në fushën e sigurisë ushqimore-4
2. Efektiviteti në krijimin e aksesit të pakufizuar dhe rritjen e aftësive konkurruese për Shqipërinë në tregjet ndërkombëtare të ushqimit-5
3. Efektiviteti në përforcimin e mjedisit rregullator dhe promovimin e prodhimit dhe i cilësisë së qëndrueshme të ushqimit nëpërmjet zhvillimit të një sektori konkurrues dhe inovativ agroushqimor-5
4. Efektiviteti i forcimit të kapacitetet institucionale dhe administrative drejt harmonizimit të *Acquis Communautaire* të BE-së në fushën e sigurisë ushqimore, shëndetit të kafshëve dhe të bimëve-3

5. Kosto – efektiviteti- 5

Për të bërë dallimin e opsioneve nga njëra-tjetra dhe me qëllim përzgjedhjen e opsionit më të mirë secili kriter është vlerësuar me një peshë specifike vlerësuar nga 1-5. Gjithashtu, secili kriter në varësi të peshës së tij, është vlerësuar me pikë përkatëse sipas shkallës së preferencës për çdo opsion për secilin kriter nga 0-5 ku 0 përfaqëson opsionin më pak të preferuar dhe 5 atë më të preferuarin.

Matrica e performancës: Matrica e performancës:

Kriteret	Pesha (Rëndësia relative)	Opsioni 0		Opsioni 1		Opsioni 2		Opsioni 3	
		Pikë	Vlera (= Pesha x pikë)	Pikë	Vlera (=Pesha x pikë)	Pikë	Vlera (=Pesha x pikë)	Pikë	Vlera (=Pesha x pikë)
1. Efektiviteti në ruajtjen dhe trajtimin e kujdesshëm të interesave të operatorëve të biznesit në fushën e sigurisë ushqimore	4	1	4	4	16	4	16	2	8
2. Qartësia, kuptueshmeria juridike dhe shmangia e fragmentimit normativ.	5	1	5	5	25	2	15	1	5
3. Efektiviteti në promovimin e prodhimit dhe i cilësisë së qëndrueshme të ushqimit nëpërmjet zhvillimit të një sektori konkurrues dhe	5	1	5	5	25	5	25	2	10

inovativ agroushqimor									
4. Efektiviteti i forcimit të kapacitetet institucionale dhe administrative drejt harmonizimit të Acquis Communautaire të BE-së në fushën e sigurisë ushqimore, shëndetit të kafshëve dhe të bimëve	3	0	0	3	9	2	6	2	6
5. Kosto-efektiviteti	5	1	5	5	25	3	15	2	10
Pikët totale për secilin opcion	19			100		77			39

Analiza me shumë kriterë tregon se Opsioni 1, miratimi i projektlgjit të ri “Për kontrollet zyrtare dhe veprimtari të tjera zyrtare të kryera për të garantuar zbatimin e legjislacionit mbi ushqimin dhe ushqimin për kafshë, rregullimeve mbi shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve si dhe mbi shëndetin e bimëve dhe produkteve për mbrojtjen e bimëve në Republikën e Shqipërisë” është vlerësuar me më shumë pikë dhe është zgjedhur si opsionin i preferuar.

Çështje të zbatimit

- Shpjegoni se cila njësi do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.
- Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.
- Përshkruani masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës.
- Specifikoni të gjitha kërkesat e përputhshmërisë dhe të zbatimit.

Institucionet dhe organet e ngarkuara nga ligji me zbatimin dhe monitorimin e ligjit për komntrollet zyrtare janë siç vijon:

Institucionet e parashikuara në projektligj dhe roli i tyre i detajuar

1. IPKZ – Institucioni Përgjegjës për Kryerjen e Kontrollit Zyrtar

- **Detyrat e tij:**

- Kryen kontrolle zyrtare ndaj operatorëve në fusha të tilla si siguria ushqimore, shëndeti dhe mirëqenia e kafshëve, shëndeti i bimëve dhe produktet për mbrojtjen e bimëve.
- Kontrolli bëhet pa njoftim paraprak, përveç rasteve ku dalja ka arsye të forta për t'u paralajmëruar.
- Zbaton kontrollin bazuar në risk, duke marrë parasysh historikun, karakteristikat e operatorëve dhe specifikat e OMGJ-ve (organizmave gjenetikisht të modifikuar) dhe etiketimin e produkteve.

- **Monitorimi i detyrave:**

- MBZHR mbledh raporte të rregullta nga IPKZ dhe i përdor për të vlerësuar performancën.
- Kontrolli realizohet përmes auditimeve teknike e administrative nga MBZHR.

2. IPAT – Institucioni Përgjegjës për kryerjen e aktiviteteve të tjera zyrtare

- **Detyrat e tij:**

- Mbetet përgjegjës për veprimtari zyrtare që nuk përfshihen në kontrollin zyrtar. Këto përfshijnë: verifikimin e dokumentacionit, auditime shtesë, vlerësime të mundshme të situatës, dhe aktivitete të tjera administrative lidhur me zbatimin ligjor.

- **Monitorimi i detyrave:**

- MBZHR ushtrohet kontroll teknik dhe administrativ mbi IPAT, duke përfshirë verifikimin e cilësisë së raporteve dhe objektivitetin e veprimeve të tij.

3. IPKPKK – Institucioni Përgjegjës për kryerjen e kontrollit zyrtar në Pikat e Kontrollit Kufitar

- **Detyrat e tij:**

- Kryen kontrolle zyrtare në pikat kufitare, mbi mallra si ushqim, bimë, kafshë, inpute bujqësore dhe produkte për mbrojtje bimërore që hyjnë ose dalin nga territori i Shqipërisë.

- **Monitorimi i detyrave:**

- Funksionon në bashkëpunim të ngushtë me doganat dhe agjencitë kufitare.
- Raporton drejtpërdrejt tek MBZHR për rezultatet e kontrolleve dhe performancën, duke mundësuar një vlerësim të përbashkët dhe koordinim të mëtejshëm.

4. MBZHR – Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (autoriteti qendror)

- **Detyrat e saj:**

- Koordinon të gjithë mekanizmin e kontrolleve zyrtare sipas projektligjit.
- Siguron monitorimin e përgjithshëm dhe administrativ të IPKZ, IPAT dhe IPKPKK.
- Pranon, verifikon dhe analizon raporte nga institucionet e reja dhe ndërhyr për përmirësim kur është e nevojshme.
- Përgjigjet për raportime ndaj institucioneve ndërkombëtare (p.sh., Komisioni Europian), në kuadër të kapitujve 11 dhe 12 të integritetit.

Pengesat e mundshme gjatë zbatimit të opsionit të zgjedhur mund të jenë:

- 1. Kapaciteti institucional dhe njerëzor:**

Një nga sfidat kryesore është sigurimi i kapaciteteve të mjaftueshme institucionale dhe stafit të trajnuar dhe të kualifikuar për zbatimin efektiv të projektligjit.

- 2. Buxheti dhe burimet teknologjike;**

Mungesa e fondeve të mjaftueshme dhe investimeve në teknologji mund të pengojë funksionimin e duhur dhe modernizimin e sistemeve të kontrollit.

- 3. Bashkëpunimi ndërinstitucional dhe sektori publik&privat:**

Koordinimi i dobët dhe mungesa e bashkëpunimit mes institucioneve dhe midis sektorit publik dhe atij privat mund të krijojë vështirësi në zbatimin e kontrolleve zyrtare.

- 4. Mbrojtja dhe menaxhimi i të dhënave:**

Garantimi i sigurisë, konfidencialitetit dhe menaxhimit korrekt të të dhënave përbën një sfidë të rëndësishme në përputhje me kërkesat ligjore dhe teknologjike.

- 5. Zbatimi efikas dhe monitorimi:**

Nevojitet një mekanizëm i fortë për zbatimin dhe monitorimin e masave të parashikuara, në mënyrë që të sigurohet respektimi i plotë i rregullave dhe reagim i shpejtë ndaj shkeljeve.

Të gjitha këto mund t'i vonojnë efektet e pritshme pozitive të ligjit, por gjithsesi nuk e ndalin zbatimin e tij të plotë në të ardhmen.

Disa akte nënligjore që ky projektligj parashikon janë:

1. Neni 4, pika 7 parasheh: “*Organizimi dhe funksionimi i autoriteteve kompetente të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.*

Ashtu siç citon edhe pika 7 me miratimin e VKM-ve do të miratohet organizimi dhe funksionimi i autoriteteve kompetente të parashikuara në pikën 1 të këtij neni dhe që janë:

a. autoriteti kompetent për kryerjen e kontrollit zyrtar është institucioni përgjegjës për kryerjen e kontrollit zyrtar, këtu e në vijim IPKZ;

b. autoriteti kompetent për kryerjen e aktiviteteve të tjera është institucioni përgjegjës për kryerjen e aktiviteteve të tjera, këtu e në vijim IPAT;

c. autoriteti kompetent për kryerjen e kontrollit zyrtar në pikat e kontrollit kufitar është institucioni përgjegjës për kryerjen e kontrollit zyrtar në pikat e kontrollit kufitar, këtu e në vijim IPKPKK.

2. Neni 23, pika 2 parasheh: ” *Ministri me udhëzim miraton rregullat për masat praktike të unifikuara lidhur me:*

a) kërkesat specifike dhe përmbajtja shtesë në Planin Kombëtar Shumëvjeçar të Kontrollit (PKSHK) të përcaktuar në nenin 90 të këtij ligji, me qëllim përgatitjen e pjesëve përkatëse të PKSHK sipas pikës 1, të nenit 89 të këtij ligji dhe përmbajtjen specifike shtesë të raporteve vjetore të përcaktuara në nenin 93 të këtij ligji që i paraqiten ministrit;

b) metodat që do të përdoren për marrjen e mostrave dhe për analizat dhe testet laboratorike, duke përfshirë çdo rregull.

Siç citon edhe vet pika 2 e nenit 23 parashihet miratimi me udhëzim i rregullave për masat praktike të unifikuara lidhur me kërkesat specifike në Planin Kombëtar Shumëvjeçar të Kontrollit si dhe metodat për marrjen e mostrave për analiza dhe teste laboratorike.

3. Neni 64, pika 2 parasheh: ” *Ministri me udhëzim miraton rregullat për masat praktike të izolimit dhe karantinës, të parashikuara në nënparagrafin e dytë të pikës 1 të këtij neni.* ” Ky udhëzim lidhet pikërisht me paragrafin e dytë i cili shprehet: ” *Inspektori i IPKPKK izolon ose karantinon, sipas rastit, çdo ngarkesë dhe kafshët që i përkasin asaj do të mbahen, kujdesen ose trajtohen në kushte të përshtatshme, në pritje të një vendimi të mëtejshëm. Nëse është e mundur, merret parasysh edhe interesi i ofrimit të kujdesit të veçantë për disa lloje mallrash* ”.

4. Neni 106 në pikën 1 të tij parasheh: ” *Këshilli i Ministrave miraton rregullat për funksionimin e sistemit të menaxhimit të informacionit të kontrollit zyrtar, të cilat parashikojnë* ”. Ky nen në vijim përbëhet nga 8 gërma të cilat parashikojnë specifikime teknike të sistemit, rregulla për funksionimin etj.

Disa nga masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës janë:

1. *Forcimi i kapaciteteve institucionale dhe trajnimi i stafit*
Investimi në trajnime të specializuara dhe zhvillimin e aftësive teknike të punonjësve të autoriteteve kompetente do të ndihmojë për të përballuar fluksin e punës dhe për të rritur efikasitetin e kontrolleve.
2. *Sigurimi i fondeve dhe modernizimi teknologjik*
Krijimi i një buxheti të qëndrueshëm dhe investimet në teknologji të avancuar, si sistemet elektronike të menaxhimit të informacionit, do të përmirësojnë kapacitetet për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave.
3. *Rritja e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe me sektorin privat*
Vendosja e mekanizmave formalë të komunikimit dhe koordinimit mes autoriteteve të ndryshme dhe subjekteve private do të rrisë transparencën dhe do të lehtësojë shkëmbimin e informacionit.
4. *Zhvillimi i protokolleve të mbrojtjes së të dhënave*
Implementimi i standardeve të forta për sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave do të sigurojë respektimin e ligjit dhe besimin e palëve të përfshira në proces.
5. *Krijimi i mekanizmave të monitorimit dhe raportimit*
Vendosja e sistemeve të monitorimit të vazhdueshëm dhe të raportimit të shkeljeve do të mundësojë reagim të shpejtë ndaj sfidave dhe do të përmirësojë zbatimin e ligjit në terren.

6. Miratimi i akteve nënligjore

Projektligji në nenin 117 të tij, pika 1 dhe 2 e tij parashikojnë miratimin e një sërë aktesh nënligjore. Konkretisht parashikohet që brenda dy viteve nga fillimi i afekteve juridike të ligjit (ligji hyn në fuqi më 1.8.2027) të miratohen të gjitha aktet nënligjore të parashikuara nga dispozitat e këtij projektligji.

Faza e shqyrtimit/vlerësimit

- *Jepni një përshkrim të përmbledhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.*
- *Identifikoni kriteret/treguesit për të matur arritjen e qëllimeve ose progresin drejt tyre.*

Institucionet e parashikuara në projektligj dhe roli i tyre i detajuar:

IPKZ – Institucioni Përgjegjës për Kryerjen e Kontrollit Zyrtar

- Monitorimi i detyrave:
 - MBZHR mbledh raporte të rregullta nga IPKZ dhe i përdor për të vlerësuar performancën në periudha 6 mujore dhe vjeçare.
 - Kontrolli realizohet përmes auditimeve teknike e administrative nga MBZHR, sa herë që paraqitet nevoja.

2. IPAT – Institucioni Përgjegjës për kryerjen e aktiviteteve të tjera zyrtare

- Monitorimi i detyrave:
 - MBZHR ushtron kontroll teknik dhe administrativ mbi IPAT, duke përfshirë verifikimin e cilësisë së raporteve dhe objektivitetin e veprimeve të tij. Raportet janë 3 mujore, 6 mujore dhe vjetore.

3. IPKPKK – Institucioni Përgjegjës për kryerjen e kontrollit zyrtar në Pikat e Kontrollit Kufitar

- Monitorimi i detyrave:
 - Funksionon në bashkëpunim të ngushtë me doganat dhe agjencitë kufitare në mënyrë të vazhdueshme.
 - Raporton drejtpërdrejt tek MBZHR për rezultatet e kontrolleve dhe performancën, duke mundësuar një vlerësim të përbashkët dhe koordinim të mëtejshëm në mënyrë të vazhdueshme.

4. MBZHR – Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (autoriteti qendror)

- Siguron monitorimin e përgjithshëm dhe administrativ të IPKZ, IPAT dhe IPKPKK në çdo kohë.
- Përgjigjet për raportime ndaj institucioneve ndërkombëtare (p.sh., Komisioni European), në kuadër të kapitujve 11 dhe 12 të integritetit sa herë që kryhen raportime 6 mujore ose 1 vjeçare.

Për të kryer një monitorim sa më efikas të zbatimit të projektligjit do të përdoren dhe shërbejnë edhe:

1. Numri i kontrolleve zyrtare të kryera- është tregues i volumeve dhe shtrirjes së veprimtarisë inspektuese në terren (vjetore/mujore, sipas sektorëve: ushqim, kafshë, bimë, etj).

2. Numri i shkeljeve të identifikuara dhe masave të marra – mundëson vlerësimin e efektivitetit të kontrolleve dhe zbatimit të ligjit në praktikë.
3. Shkalla e përshtatjes së operatorëve me kërkesat ligjore -vlerësuar në përqindje numri i subjekteve që respektojnë detyrimet ligjore pas kontrolleve (p.sh. rritje e përputhshmërisë me kalimin e kohës).
4. Numri i trajnimeve të kryera dhe pjesëmarrësve të trajnuar- njësi matëse matës së progresit të forcimit të kapaciteteve njerëzore.
5. Funksionaliteti i sistemit të menaxhimit të informacionit- si p.sh përqindja e kontrolleve të raportuara në sistem, koha mesatare e përpunimit të të dhënave.
6. Numri i laboratorëve të akredituar dhe analizave të kryera- është tregues i nivelit të përmirësimit të kapaciteteve teknike për diagnostikim dhe verifikim.
7. Numri i certifikatave dhe vërtetimeve zyrtare të lëshuara- njësi matëse i efikasitetit të procedurave administrative dhe zbatimit të standardeve.
8. Numri i rasteve të raportuara dhe trajtuara për mospërputhshmëri- si p.sh. sa raste janë ndjekur me masa korrigjuese, sa janë adresuar me penalitete, etj.
9. Koha mesatare e reagimit ndaj rreziqeve të identifikuara- është tregues i aftësisë për të reaguar shpejt në situata emergjente apo të jashtëzakonshme.
10. Frekuenca e auditimeve të brendshme dhe të jashtme- njësi matëse e përpjekjeve për kontroll cilësor dhe përmirësim të vazhdueshëm institucional.

Për të matur arritjen e objektivave të programeve të çrrënjësjes dhe për të siguruar një proces të efektshëm monitorimi, kriteret e matjes duhet të jenë specifike, të matshme, të arritshme, relevante dhe të përcaktuara në kohë (SMART). Më poshtë paraqiten disa prej tyre:

1. Shkalla e përshtatjes së operatorëve me kërkesat ligjore 2 vite pas miratimit të projektligjit;
2. Numri i laboratorëve të akredituar dhe analizave të kryera 2 vite pas miratimit të projektligjit;
3. Funksionaliteti i sistemit të menaxhimit të informacionit gjatë vitit të parë pas miratimit të projektligjit;
4. Niveli i investimeve në këtë sektor krahasuar me periudhën përpara miratimit të projektligjit;
5. Numri i shkeljeve të identifikuara dhe masave të marra gjatë vitit të parë pas miratimit të projektligjit.

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca2/a

Tabela: Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuara në milionë lekë e zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në.

Status Quo

	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Viti 8	Viti 9	Viti 10
Faktorizbritës	<u>1</u>	<u>0.952</u> <u>835</u>	<u>0.907</u> <u>894</u>	<u>0.86</u> <u>5073</u>	<u>0.824</u> <u>271</u>	<u>0.785</u> <u>394</u>	<u>0.748</u> <u>351</u>	<u>0.713</u> <u>055</u>	<u>0.679</u> <u>423</u>	<u>0.6473</u> <u>78</u>
Kosto për buxhetin – njëherë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0

Kosto përbuxhetin – nëvazhdim	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Kosto për biznesin – njëherë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Kosto përbiznesin – nëvazhdim	90.3	90.3	94.8	94.8	94.8	94.8	94.8	94.8	94.8	94.8
Kosto për grupet e tjera – njëherë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Kosto për grupet e tjera – në vazhdim	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Kosto në total	90.30	90.30	94.80	94.80	94.80	94.80	94.80	94.80	94.80	94.80
Kosto e zbriturnë total = Kosto në total x faktorinzbritës	90.30	86.04	86.07	82.01	78.14	74.46	70.94	67.60	64.41	61.37
Faktorizbritës	<u>1</u>	<u>0.952</u> <u>83468</u> <u>3</u>	<u>0.907</u> <u>89393</u> <u>3</u>	<u>0.86</u> <u>5072</u> <u>828</u>	<u>0.824</u> <u>2713</u> <u>94</u>	<u>0.785</u> <u>39437</u> <u>3</u>	<u>0.748</u> <u>35099</u> <u>9</u>	<u>0.713</u> <u>05478</u> <u>7</u>	<u>0.679</u> <u>42333</u> <u>2</u>	<u>0.6473</u> <u>78115</u>
Përfitimipërbuxhetin – nëvazhdim	90.3	90.3	90.3	90.3	90.3	90.3	90.3	90.3	90.3	90.3
Përfitimipërbiznesin – njëherë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Përfitimipërbiznesin – nëvazhdim	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Përfitimi për grupet e tjera – njëherë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Përfitimi për grupet e tjera – në vazhdim	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Kosto për buxhetin – në vazhdim	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Përfitimi në total	90.3	90.3	90.3	90.3	90.3	90.3	90.3	90.3	90.3	90.3
Përfitimiizbriturnë total = Përfitimine total x faktorinzbritës	90.30	86.04	81.98	78.12	74.43	70.92	67.58	64.39	61.35	58.46
Vlera aktuale e kostonë total	733.57 lekë									
Vlera aktuale e përfitimit në total	733.57 lekë									
Vlera aktuale neto (VAN) = Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e kostonë total	0 lekë									

Opsioni 1

	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Viti 8	Viti 9	Viti 10
Faktorizbritës	<u>1</u>	<u>0.952</u> <u>835</u>	<u>0.907</u> <u>894</u>	<u>0.86</u> <u>5073</u>	<u>0.824</u> <u>271</u>	<u>0.785</u> <u>394</u>	<u>0.748</u> <u>351</u>	<u>0.713</u> <u>055</u>	<u>0.679</u> <u>423</u>	<u>0.6473</u> <u>78</u>

Kosto për buxhetin – njëherë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Kosto për buxhetin – në vazhdim										
Kosto për biznesin – njëherë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Kosto për biznesin – në vazhdim	90.3	90.3	94.8	94.8	94.8	94.8	94.8	94.8	94.8	94.8
Kosto për grupet e tjera – njëherë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Kosto për grupet e tjera – në vazhdim	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Kosto në total	90.30	90.30	94.80	94.80	94.80	94.80	94.80	94.80	94.80	94.80
Kosto e zbritur në total = Kosto në total x faktorizmit	90.30	86.04	86.07	82.01	78.14	74.46	70.94	67.60	64.41	61.37
Faktorizmit	<u>1</u>	<u>0.952</u> <u>83468</u> <u>3</u>	<u>0.907</u> <u>89393</u> <u>3</u>	<u>0.86</u> <u>5072</u> <u>828</u>	<u>0.824</u> <u>2713</u> <u>94</u>	<u>0.785</u> <u>39437</u> <u>3</u>	<u>0.748</u> <u>35099</u> <u>9</u>	<u>0.713</u> <u>05478</u> <u>7</u>	<u>0.679</u> <u>42333</u> <u>2</u>	<u>0.6473</u> <u>78115</u>
Përfitim për buxhetin – në vazhdim	90.3	90.3	94.8	94.8	94.8	94.8	94.8	94.8	94.8	94.8
Përfitim për biznesin – njëherë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Përfitim për biznesin – në vazhdim	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Përfitimi për grupet e tjera – njëherë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Përfitimi për grupet e tjera – në vazhdim	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Kosto për buxhetin – në vazhdim	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Përfitimi në total	90.3	90.3	94.8	94.8	94.8	94.8	94.8	94.8	94.8	94.8
Përfitimi i zbritur në total = Përfitim në total x faktorizmit	90.30	86.04	86.07	82.01	78.14	74.46	70.94	67.60	64.41	61.37
Vlera aktuale e kostonë në total	761.34 lekë 761.34 lekë 0 lekë									
Vlera aktuale e përfitimit në total										
Vlera aktuale neto (VAN) = Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e kostonë në total										

Theksohet se kjo analizë është hipotetike.

Vlerësimi sasior i ndikimit financiar të projektligjit është bazuar në të dhënat e realizimit të të ardhurave për vitin 2024 nga institucionet vartëse së Ministrisë së Bujqësisë dhe

Zhvillimit Rural (AKVMB, AKU dhe ISUV), të cilat kanë gjeneruar gjithsej 90.3 milion lekë të ardhura për buxhetin e shtetit, të gjeneruara nga 32,747 operatorë (burimi: Sektori i Buxhetit në MBZHR). Këto të ardhura burojnë nga disa zëra kryesorë: 1.5 milion lekë nga licencat dhe lejet për shoqëritë private që operojnë në fushën e mbrojtjes së bimëve dhe veterinarisë, 37.3 milion lekë nga gjobat dhe urdhër-zhdëmtimet, 3.5 milion lekë nga taksat e regjistrimit, pullat dhe tarifat e tjera shoqëruese, 5.8 milion lekë nga shitjet dhe veprimtaritë e drejtpërdrejta si analizat kimike-biologjike, si dhe rreth 42.2 milion lekë nga kamatëvonesat, pagesat për shërbime dhe certifikatat veterinare.

Duke qenë se projektligji parashikon vendosjen e tarifave minimale shtesë për kryerjen e kontrolleve zyrtare, është supozuar një **rritje minimale prej rreth 5% e të ardhurave** vjetore, ekuivalente me afërsisht +4.5 milion lekë, në tota 94.8 milion lekë, **e cila pritjet të reflektohet dy vite pas miratimit të ligjit.**

Në analizën financiare është përfshirë vetëm komponenti i tarifave të detyrueshme për kontrollet zyrtare, si i vetmi element i matshëm dhe i verifikueshëm për të cilin ekzistojnë të dhëna të plota institucionale. Kategoritë e tjera të kostove që mund të përballen nga bizneset (kosto administrative të përputhshmërisë, investime teknike dhe infrastrukturore, kosto të vazhdueshme operacionale dhe ndikime në konkurrueshmëri) nuk janë përfshirë, për shkak të mungesës së të dhënave statistikore, baseline-ve sektoriale dhe informacionit të detajuar mbi kostot e brendshme të operatorëve ekonomikë. Për rrjedhojë, nuk është e mundur një vlerësim i plotë dhe i besueshëm i kostos totale që ligji mund të gjenerojë për sektorin privat, pasi këto kosto varjonë sipas kapaciteteve të secilit biznes.

Analiza e Vlerës Aktuale Neto (VAN) është kryer për një periudhë 10-vjeçare, duke përdorur një normë diskontimi prej 5% në vit.

Në osionin “Status Quo”, nuk parashikohen ndryshime ligjore apo financiare dhe situata rezulton ekonomikisht neutrale, me VAN = 0.

Në opsionin “Opsioni 1”, ku kontrollet zyrtare kryhen me pagesë minimale nga operatorët ekonomikë, reflektohet **rritja hipotetike e të ardhurave +5% pas vitit të dytë** (duke qenë se ligji hyn në fuqi dy vite pas miratimit) për tarifat minimale shtesë për kryerjen e kontrolleve zyrtare, por gjithsesi ruhet neutraliteti financiar (VAN = 0), pasi rritja e të ardhurave shoqërohet me rritje proporcionale të kostove të administrimit dhe mbledhjes.

Megjithatë, Opsioni 1 paraqet një ndikim pozitiv për financat publike, pasi krijon një burim shtesë dhe të qëndrueshëm të ardhurash, lehtëson buxhetin e shtetit për mbulimin e shpenzimeve operative dhe mbështet zbatimin më efikas të kontrolleve zyrtare.

Zbatimi i projektligjit nuk parashikon kosto shtesë për buxhetin e shtetit, pasi do të mbështetet në strukturat ekzistuese administrative, laboratorike dhe njerëzore të institucioneve vartëse, të cilat janë aktualisht në proces riorganizimi dhe modernizimi, si dhe kontribuon në përafrimin me legjislacionin e Bashkimit Evropian në fushën e sigurisë ushqimore dhe mbrojtjes së shëndetit publik.

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca2/b

Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsiioni

Opsioni	Vlera aktuale në milionëlekë		Vlera aktuale neto në milionëlekë
	Kosto	Përfitimi	
Status quo	733.57	733.57	0
Opsioni 1	761.34	761.34	0

Edhe pse rezultati numerik i VAN është neutral për të dy opsionet, efekti ekonomik dhe institucional i Opsionit 1 është pozitiv, pasi nxit rritjen e të ardhurave publike, forcon sistemin e mbikëqyrjes dhe krijon një bazë të qëndrueshme për vetëfinancimin e shërbimeve të lidhura me kontrollet zyrtare.